



**PROGRAMI I LËNDËS “GJEOGRAFI”
ARSIMI I MESËM I LARTË
KLASA 10
FUSHA “SHKENCAT SHOQËRORE”**

PROGRAM I PËRDITËSUAR

Koordinator: Evis Mastori





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

6866/7
Nr. _____/Prot.

Tiranë, më 28.10.2025

URDHËR

Nr. 556, datë 28.10.2025

PËR

**MIRATIMIN E PROGRAMEVE MËSIMORE TË DISA LËNDËVE TË
KURRIKULËS BËRTHAMË DHE TË KURRIKULËS ME ZGJEDHJE, TË
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 45 të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjave “dh” dhe “e”, të pikës 5, të kreut III, të vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)” dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.09.2025 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit znj. Orjana Osmani”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Gjuhë shqipe”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Letërsi”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Miratimin e “Programit mësimor të përditësuar, të lëndës “Gjuhë angleze”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 3, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
4. Miratimin e “Programit mësimor të lëndës “Qytetari”, të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë”, sipas shtojcës 4, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

5. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Histori", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 5, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
6. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjeografi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 6, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
7. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Muzikë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 7, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
8. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Art pamor", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 8, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
9. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Teatër", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 9, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
10. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 10, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
11. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Matematikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 11, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
12. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Fizikë", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 12, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
13. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Kimi", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 13, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
14. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Biologji", të kurrikulës bërthamë, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 14, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
15. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Gjuhë e huaj e dytë", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 15, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
16. Miratimin e "Programit mësimor të përditësuar, të lëndës "Edukim fizik, sport dhe shëndet", të kurrikulës me zgjedhje, për klasën e dhjetë dhe klasën e njëmbëdhjetë dhe klasën e dymbëdhjetë të arsimit të mesëm të lartë", sipas shtojcës 16, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
17. Programet mësimore të klasës së dhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2026 – 2027.
18. Programet mësimore të klasës së njëmbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2027 – 2028.
19. Programet mësimore të klasës së dymbëdhjetë hyjnë në fuqi dhe fillojnë zbatimin në vitin shkollor 2028 – 2029.
20. Programet mësimore të mëparshme, shfuqizohen sipas fillimit të zbatimit të programeve mësimore të lëndëve në klasat e sipërcituara.

21. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



PËRMBAJTJA

1	HYRJE	4
2	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS	6
2.1	Objektivat e përgjithshme të gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë	6
3	PËRMBAJTJA E PROGRAMIT	7
4	KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA	9
4.1	Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit	9
4.2	Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjeografisë	14
4.3	Kompetencat e lëndës së gjeografisë dhe rezultatet e të nxënit.....	18
5	PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	23
5.1	Koha mësimore për secilën tematikë/nëntematikë për klasën e dhjetë.....	23
5.2	Përmbajtja e klasës së dhjetë.....	24
5.2.1	TEMATIKA: PROCESET NATYRORE DHE SHOQËRORE.....	25
5.3	Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.	38
6	METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES	47

6.1	Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e gjeografisë	49
6.2	Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjeografisë	50
6.3	Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë.....	52
6.4	Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë.....	54
7	VLERËSIMI I NXËNËSVE	55
7.1	Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit.	60
8	BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE.....	61
9	REKOMANDIME TË TJERA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	63
10	NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE	68

1 HYRJE

Gjeografia është shkencë që ndihmon nxënësit të kuptojnë në mënyrë të thelluar mjedisin natyror dhe shoqëror në të cilin jetojnë, dhe ndërveprimin midis tyre. Përmes mësimit të gjeografisë, nxënësit fitojnë njohuri dhe aftësi që i ndihmojnë të kuptojnë karakteristikat natyrore dhe shoqërore të hapësirës gjeografike, larmishmërinë e vendeve dhe rajoneve, kulturat dhe mënyrat e jetesës, ndërvarësinë midis njerëzve dhe mjedisit, dhe të zhvillojnë një perspektivë të gjerë dhe të informuar për botën, duke përfshirë dimensionin lokal, kombëtar, rajonal dhe global.

Si një lëndë e fushës së shkencave shoqërore, gjeografia është pjesë e kurrikulës bërthamë dhe me zgjedhje në arsimin e mesëm të lartë dhe kontribuon në formimin e përgjithshëm të nxënësit.

Programi i gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë synon të zhvillojë aftësi të mendimit kritik dhe krijues, vëzhgimit, analizës dhe zgjidhjes së problemeve. Ai i ndihmon nxënësit të ndërtojnë një vizion të gjerë dhe të qëndrueshëm për botën, duke i përgatitur për të qenë qytetarë aktivë, të informuar dhe të përgjegjshëm. Edukimi gjeografik u jep nxënësve mjetet për të marrë vendime të informuara dhe për të kontribuar pozitivisht në shoqëri.

Ndryshimet e mëdha që po përjeton shoqëria bashkëkohore, sidomos në fushën e komunikimit, teknologjisë, globalizmit, kanë ndikuar thellësisht në mënyrën si e perceptojmë hapësirën dhe marrëdhënien me mjedisin. Në këtë kontekst, gjeografia kontribuon në edukimin për bashkëjetesën, përgjegjësinë qytetare dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke u ofruar nxënësve mjetet për të kuptuar sfidat mjedisore dhe për të reflektuar mbi mënyrat e bashkëjetesës harmonike me natyrën dhe me njëri-tjetrin.

Programi i gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë është ndërtuar mbi parimin e zhvillimit të kompetencave kyçe, të cilat janë themelore për të nxënë gjatë gjithë jetës. Përmbajtja mësimore nuk ofrohet si qëllim në vetvete, por si mjet për ndërtimin e njohurive të zbatueshme në situata

konkrete të të nxënit. Nxënësi nxitet të mendojë në mënyrë kritike dhe krijuese, të analizojë dhe të zgjidhë probleme gjeografike duke përdorur mjetet gjeografike, si harta, diagrame, të dhëna statistikore, platforma digjitale etj.

Vëzhgimi i drejtpërdrejtë, puna në terren, analiza e shpërndarjes hapësinore të veçorive natyrore dhe shoqërore dhe interpretimi i ndërvarësisë mes tyre, janë ndër veprimtaritë që zhvillojnë aftësitë themelore gjeografike të nxënësit. Përmes tyre, nxënësi mëson të ndërtojë kuptime më të thella për vendin ku jeton dhe për botën në tërësi.

Hartimi i programit të gjeografisë mbështetet në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar, Kurrikulën bërthamë të Arsimit të Mesëm të Lartë dhe Planin Mësimor të Arsimit të Mesëm të Lartë.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHME TË LËNDËS

Gjeografia në arsimin e mesëm të lartë ka për qëllim të zhvillojë tek nxënësit një kuptim të thellë të marrëdhënieve komplekse midis njeriut dhe mjedisit natyror, duke i pajisur ata me njohuri të gjera mbi proceset dhe dukuritë gjeografike që ndodhin në Tokë, mbi shpërndarjen hapësinore të popullsisë dhe aktivitetëve ekonomike. Nëpërmjet studimit rajonal të hapësirës gjeografike synohet që nxënësit, duke analizuar shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, të aftësohen për të mbajtur qëndrime dhe për të analizuar sfida globale si ndryshimet klimatike, migrimet etj., duke vlerësuar nevojën për zhvillim të qëndrueshëm.

Gjeografia në këtë nivel shkollimi synon të formojë qytetarë të vetëdijshëm për rolin e tyre në shoqëri, që kuptojnë botën si një sistem të ndërlidhur dhe dinamik, ku çdo vendim dhe veprim ka ndikim në hapësirë, kohë dhe mjedis.

2.1 Objektivat e përgjithshme të gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë

Në përfundim të arsimit të mesëm të lartë, nxënësi do të jetë i aftë:


- të zhvillojë dijet për dukuritë gjeografike, në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe botëror, mbi bazën e ballafaqimit të vazhdueshëm të të menduarit kritik e krijues;
- të zhvillojë kuptimin për ligjet e përgjithshme të gjeosistemit dhe të veprojë në përputhje me to për zgjidhjen e problemeve gjeografike të jetës së përditshme;
- të zhvillojë interesin dhe respektin për vendin ku jeton, për vende të tjera, për njerëzit dhe mënyrën si ata ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe mjedisin ku jetojnë;

- të kuptojë rolin e tij si qytetar në një shoqëri të ndërlidhur globalisht dhe të zhvillojë qëndrime respektuese ndaj diversitetit dhe bashkëjetesës paqësore;
- të kuptojë mundësitë dhe sfidat e ndërvarësisë globale;
- të lidhë njohuritë gjeografike me fusha të tjera të dijes, duke përdorur qasjen ndërdisiplinore;
- të zhvillojë shkathtësitë për të qenë përdorues kritik dhe krijues i metodave të kërkimit gjeografik;
- të kuptojë dhe të zbatojë mënyra etike dhe të përgjegjshme të përdorimit të teknologjisë gjatë përmbushjes së detyrave mësimore dhe kërkimeve gjeografike;
- të zotërojë terminologjinë dhe mjetet specifike të gjeografisë, duke i zbatuar në situata të ndryshme të të nxëniet dhe të jetës së përditshme;
- të punojë në mënyrë bashkëpunuese dhe efektive në zgjidhjen e problemeve përmes projekteve, detyrave në grup dhe diskutimeve të strukturuar;
- të zhvillojë vetëbesim, këmbëngulje dhe një qëndrim pozitiv ndaj sfidave, duke kuptuar rëndësinë e të menduarit gjeografik në jetën e përditshme dhe në orientimin profesional;
- të edukohet si qytetar i informuar, i përgjegjshëm dhe aktiv, i cili mund të kontribuojë për zhvillimin e një bote të qëndrueshme.

3 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i gjeografisë synon të krijojë kushte të favorshme për ndërtimin dhe zhvillimin e kompetencave të lëndës dhe të kompetencave kyçe, duke u mbështetur në situata të jetës reale dhe në kontekstin shkollor. Ky program përqendrohet në formimin e nxënësve si individë të aftë për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar njohuritë gjeografike në mënyrë funksionale dhe të ndërgjegjshme në jetën e tyre të përditshme.

Diagrama 1. Përmbajtja e programit lëndor të gjeografisë



4 KOMPETENCAT DHE AFTËSITË QË ZHVILLON LËNDA

4.1 Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit

Lënda e gjeografisë kontribuon drejtpërdrejt në ndërtimin e kompetencave kyçe dhe aftësive të shekullit 21-të si: të menduarit kritik e krijues, zgjidhja e problemeve, aftësitë sociale të bashkëpunimit, aftësitë digjitale etj. Përmes përmbajtjes së saj, gjeografia ndihmon në formimin e qytetarit të aftë për të analizuar proceset natyrore dhe shoqërore, për të kuptuar marrëdhëniet midis njeriut dhe mjedisit, dhe për të marrë vendime të informuara në jetën e përditshme.

Zhvillimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të nxënies kërkon që mësuesi të sigurojë një lidhje të qëndrueshme dhe funksionale midis kompetencave kyçe dhe atyre të lëndës. Kjo kërkon një planifikim të kujdesshëm të situatave të të nxënit, si dhe përzgjedhjen e metodave, mjeteve dhe burimeve të përshtatshme që nxisin angazhimin, reflektimin dhe zbatimin praktik të njohurive.

Në tabelën e mëposhtme përshkruhen rezultatet e të nxënit për kompetencat kyçe që nxënësi zhvillon në klasën e dhjetë në lëndën e gjeografisë:

Tabela 1. Kompetencat kyçe dhe rezultatet e të nxënit.

Kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare	Kompetenca e komunikimit në gjuhë të huaja
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhën amtare, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">komunikon si dëgjues, folës, lexues dhe shkruar në situata gjatë të nxënit të gjeografisë;përshtat komunikimin e tij me kërkesat e situatës;	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e komunikimit në gjuhë të huaj, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none">komunikon në gjuhë të huaj, duke krijuar një atmosferë pozitive dhe mbështetëse;

<ul style="list-style-type: none"> • përdor dhe dallon lloje të ndryshme tekstesh, përfshirë tekstet digjitale; • kërkon, mbledh dhe përpunon informacione gjeografike duke përdorur mjete ndihmëse; • formulon dhe shpreh argumente me gojë dhe me shkrim në përshtatje me kontekstin; • shpreh para një audience të caktuar, çështjet thelbësore të ngritura në një interpretim për një temë të caktuar të gjeografisë, përmes së paku një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave etj.); • diskuton në grup, në mënyrë konstruktive duke dhënë informacion, argumente dhe duke shtruar pyetje në një dialog prej disa minutash, për një temë të caktuar në gjuhën amtare; • prezanton një temë të caktuar nga gjeografia dhe në mënyrë efektive komunikon me audiencën, duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike; • përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënit. 	<ul style="list-style-type: none"> • parashtron pyetje që kërkojnë reagime nga këndvështrime të ndryshme; shkruan qartë tekste të detajuara për tema që lidhen me fushën e tij të interesit, duke sintetizuar dhe vlerësuar informacionin dhe argumentet nga një sërë burimesh; • përshkruan dhe prezanton qartë dhe me detaje tema që lidhen me fushën e tij të interesit; • përdor drejt strukturën dhe rregullat e drejtshkrimit të gjuhës së huaj, në një numër të caktuar kontekstesh, si: ese etj.; • lexon rrjedhshëm një tekst në gjuhë të huaj; • shpreh qëndrimin e tij për një temë të lidhur me mjedisin, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit, me gojë ose me shkrim; • përdor në mënyrë efektive, programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënit.
<p>Kompetenca në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri</p>	<p>Kompetenca digjitale</p>
<p><i>Për të dëshmuar kompetencat në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • ndjek dhe vlerëson organizimin logjik të argumenteve; 	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën digjitale, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor, filtron, përpunon dhe vlerëson përmbajtje digjitale; • interpreton dhe analizon të dhënat për të nxjerrë përfundime

<ul style="list-style-type: none"> • përdor mjete ndihmëse të përshtatshme, duke përfshirë të dhënat statistikore dhe grafikët; • përdor mjetet dhe pajisjet teknologjike; • komunikon përfundimet dhe arsyetimet që çuan në një përfundim të bazuar në prova; • gjykon rezultatet e arritura, nga analiza e të dhënave të një projekti dhe i interpreton ato me gjuhën gjeografike, i paraqet grafikisht, në formë tabelore, duke nxjerrë përfundime të vërtetuara (p.sh., një projekt për analizën e ndryshimeve të temperaturës mesatare vjetore në qytetingjatë periudhës 2000-2024 etj.); • hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar; • identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem; • vlerëson cilësinë e informacioneve në një material të shkruar për një temë të caktuar (p.sh., për ngrohjen globale, për diversitetin kulturor etj.), identifikon elementet kryesore, i diskuton me moshatarët, duke dhënë propozime konkrete për shfrytëzimin e shembujve pozitivë në kontekstin lokal apo global, dhe duke shprehur qëndrimin personal. 	<ul style="list-style-type: none"> dhe për të marrë vendime të mirë informuara; • identifikon dhe zgjidh probleme të ndryshme duke përdorur teknologjinë dhe mjediset digjitale; • menaxhon dhe mbron informacionin, përmbajtjen, të dhënat dhe identitetet digjitale; • përdor mjete digjitale për të prodhuar, për të paraqitur dhe për të kuptuar informacione komplekse; • demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënies (p.sh., për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve etj.); • përdor programet e TIK-ut në mënyrë efektive për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënies; • prezanton një projekt, duke përdorur sekuenca animimesh, videosh, figurash për demonstrimin e temave mësimore; • vlerëson cilësinë e informacionit që gjen nga një shumëllojshmëri burimesh dhe mediash; • tregon rregullat e sigurisë që duhen zbatuar për të ruajtur privatësinë personale sipas kodit të etikës së komunikimit personal dhe në grup; • është aktiv dhe i pavarur në procesin e mësimdhënies dhe
--	--

	mësim nxënies për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.
Kompetenca personale, shoqërore dhe e të nxëniet	Kompetenca qytetare
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën personale, shoqërore dhe të nxënies, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • organizon të nxëniet, fokusohet dhe vendos qëllime; • vlerëson në mënyrë kritike punën e tij duke iu referuar qëllimeve fillestare; • motivon dhe vlerëson veten; • mëson dhe punon në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim; • shpreh dëshirë dhe vlerëson nevojën për të nxëniet gjatë gjithë jetës; • komunikon në mënyrë konstruktive dhe bashkëpunon në ekip; • menaxhon në mënyrë efektive burimet, kohën, njerëzit, karrierën, mjedisin dhe ndërveprimet e tij me shoqërinë; • negocion në mënyrë efektive, kupton ndjenjat, mendimet dhe perspektivat e të tjerëve; • menaxhon stresin, pasigurinë dhe zgjidh konfliktet ndër personale në mënyrë konstruktive; • bën përpunimin e informacioneve për një temë të caktuar në mënyrë të pavarur dhe efektive, rezultatet e punës i prezanton me shkrim ose me gojë para të tjerëve, duke dhënë shpjegime për mënyrën e zgjedhjes dhe 	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën qytetare, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • angazhohet në mënyrë efektive me të tjerët në çështjet publike; • tregon solidaritet dhe interes në zgjidhjen e problemeve; • merr pjesë në mënyrë konstruktive në aktivitetet e komunitetit; • vlerëson diversitetet dhe demonstroi tolerancë, mirëkuptim, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; • demonstroi vlerat dhe parimet e të drejtave të njeriut në jetën e përditshme (p.sh. respekti i dinjitetit personal, luftimi i paragjykimeve dhe diskriminimit të të gjitha llojeve; promovimi i barazisë gjinore etj.); • demonstroi sjellje etike dhe të përgjegjshme ndaj mjedisit natyror dhe kontribuon në qëndrueshmërinë mjedisore. • prezanton mënyrën e funksionimit të mjedisit shoqëror në nivel lokal dhe me gjerë, si dhe me shembuj konkretë tregon

<p>të shfrytëzimit të burimeve të informacionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh., vlerat kulturore të rajonit të vet etj.) duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit dhe e paraqet para të tjerëve. 	<p>kontributin e vet në ruajtjen dhe kultivimin e vlerave të mjedisit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • paraqet në forma të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të diversitetit në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët, duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve; • ilustron me shembuj nga jeta e përditshme, praktikat e menaxhimit dhe të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë konstruktive, duke ndarë me të tjerët përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta gjatë diskutimeve të shembujve ilustrues në këtë fushë; • ilustron me shembuj zgjidhjen e problemeve të caktuara në nivel shkolle ose komuniteti, duke i lidhur me njohuritë gjeografike dhe i arsyeton ato me argumente (p.sh., menaxhimin e situatave emergjente në rastet e fatkeqësive natyrore, si tërmetet, përmytjet apo rrëshqitjet e dheut).
<p style="text-align: center;">Kompetenca e sipërmarrjes</p>	<p style="text-align: center;">Kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore</p>
<p><i>Për të dëshmuar kompetencën e sipërmarrjes, nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • mendon në mënyrë strategjike dhe zgjidh problemin; 	<p><i>Për të dëshmuar kompetencën për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, nxënësi:</i></p>

- | | |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> • përdor imagjinatën e tij gjatë proceseve krijuese dhe novatore; • menaxhon projektet, planifikon, organizon, drejton dhe delegon; • identifikon pikat e forta dhe kufizimet; • punon në mënyrë të pavarur si dhe bashkëpunon me të tjerët; • përcakton prioritetet, jep zgjidhje cilësore për përmirësimin e mjedisit; • ndërmerri iniciativë në aktivitete të ndryshme me interes për lëndën e gjeografisë; • paraqet kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillimin e karrierës në një fushë të caktuar. | <ul style="list-style-type: none"> • njeh, respekton dhe çmon kulturën e tij si dhe vlerat, besimet dhe kulturat e të tjerëve; • shpreh idetë dhe mendimet në medie të ndryshme, duke përdorur në mënyrë efektive kapacitetet personale dhe duke i zhvilluar ato vazhdimisht për të komunikuar në mënyrë të qartë, të vetëdijshme dhe të përshtatshme për audiencën. |
|---|--|

4.2 Temat ndërkurrikulare dhe lidhja me lëndën e gjeografisë

Gjeografia krijon një lidhje të drejtpërdrejtë mes dijes shkollore dhe jetës reale, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë botën që i rrethon. Programi i saj luan një rol kyç në trajtimin e temave ndërkurrikulare, pasi nëpërmjet analizës së hapësirës, mjedisit dhe marrëdhënieve njerëzore, gjeografia krijon mundësi për të eksploruar çështje si zhvillimi i qëndrueshëm, ndryshimet klimatike, migracioni, globalizimi dhe drejtësia mjedisore, duke i lidhur ato me situata konkrete dhe kontekste të përditshme. Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësi për të menduar në mënyrë kritike, për të bashkëpunuar, për të reflektuar mbi vlerat demokratike dhe për të vepruar me ndërgjegje dhe përgjegjësi në një botë dinamike dhe të ndërlidhur.

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur, përshkruhet si gjeografia mundëson trajtimin e temave ndërkurrikulare:

a) Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave

Gjeografia i pajis nxënësit me njohuri për vendin e tyre, për pasuritë natyrore, diversitetin dhe trashëgiminë natyrore dhe kulturore, si dhe për veçoritë e zhvillimit ekonomik e shoqëror, duke kontribuar në ndërtimin e vetëdijes kombëtare dhe forcimin e identitetit kombëtar. Përmes studimit të kulturave të ndryshme dhe mënyrave të jetesës në vende të ndryshme të botës, nxënësit zhvillojnë tolerancën dhe respektin për diversitetin kulturor.

b) Qytetaria aktive dhe sipërmarrja

Gjeografia luan një rol të rëndësishëm në formimin e qytetarëve të përgjegjshëm dhe të angazhuar në jetën shoqërore dhe ekonomike; ajo nxit mendimin kritik, analizën e problemeve reale si dhe angazhimin aktiv të nxënësve për zgjidhjen e tyre. Përmes mësimit të gjeografisë, nxënësit eksplorojnë burimet natyrore, potencialin ekonomik të zonave të ndryshme, ndikimin e infrastrukturës në zhvillim. Kjo i ndihmon të identifikojnë mundësitë për zhvillim, ekonomik dhe shoqëror, duke mbështetur zhvillimin e sipërmarrjes.

c) Shëndeti mendor, fizik dhe siguria

Gjeografia u mundëson nxënësve të identifikojnë zonat e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore, si tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet e dheut etj., dhe të kuptojnë pasojat që ato kanë mbi shëndetin dhe mirëqenien e komuniteteve. Ajo ndihmon në kuptimin e ndikimit të ndotjes mjedisore në shëndetin fizik dhe mendor të njerëzve. Përmes edukimit për mjedisin, nxënësit mësojnë sjellje të sigurta dhe të përgjegjshme në situata të ndryshme, si dhe aftësi për të parandaluar dhe përballuar emergjencat natyrore.

d) Zhvillimi i qëndrueshëm dhe qëndrueshmëria mjedisore

Kjo temë ndërkurrikulare përbën një nga shtyllat kryesore të gjeografisë, duke nxitur te nxënësit një kuptim të thelluar të ndërveprimit midis njeriut dhe natyrës. Përmes studimit të gjeografisë, nxënësit mësojnë për shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për ndikimin e aktivitetit njerëzor në ndryshimet klimatike dhe anasjelltas, për pasojat e urbanizimit të pakontrolluar dhe nevojën për ruajtjen e ekuilibrave mjedisore etj.;

ata zhvillojnë aftësi për të analizuar probleme mjedisore në nivel lokal dhe global, dhe për të identifikuar zgjidhje praktike që mbështesin ruajtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm. Gjeografia luan një rol kyç në edukimin për mënyra të qëndrueshme jetese, duke forcuar ndërgjegjësimin, përgjegjësinë dhe angazhimin qytetar të nxënësve ndaj sfidave mjedisore të kohës sonë.

e) Teknologjia, shoqëria dhe media

Në lëndën e gjeografisë, nxënësit mësojnë të përdorin harta digjitale, kërkojnë informacione online dhe mësojnë të kuptojnë të dhëna që lidhen me vende dhe mjedise të ndryshme. Ata zhvillojnë aftësi për të lexuar dhe analizuar informacione hapësinore, si edhe për të kuptuar se si vendndodhja ndikon në jetën e përditshme. Kjo i ndihmon nxënësit të përdorin teknologjinë në mënyrë të përgjegjshme, të kuptojnë si merren vendime në bazë të informacionit dhe të përdorin median për të mësuar dhe për t'u informuar si pjesë e shoqërisë.

Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi për trajtimin e temave ndërkurrikulare:

Lidhja e natyrshme e përmbajtjes me temat ndërkurrikulare

Gjeografia si disiplinë lidhet natyrshëm me shumë tema ndërkurrikulare, si zhvillimi i qëndrueshëm, mjedisi, qytetaria aktive, të drejtat e njeriut, shëndeti, edukimi për paqe etj. Mësuesi duhet të identifikojë qartë këto lidhje dhe t'i integrojë në përmbajtjen mësimore përmes të pyeturit, situatave të rastit, projektit kurrikular etj.

Planifikimi i integruar

Gjatë planifikimit, mësuesi duhet të parashikojë se cilat tema ndërkurrikulare do të trajtohen dhe si do të lidhen me kompetencat dhe përmbajtjen e gjeografisë. Kjo duhet të reflektohet në rezultatet e të nxënësve, veprimtaritë mësimore, materialet dhe mënyrat e vlerësimit.

Zhvillimi i kompetencave kyçe

Trajtimi i temave ndërkurrikulare në gjeografi duhet të kontribuojë në zhvillimin e kompetencave kyçe të nxënësit.

Përdorimi i metodave aktive dhe bashkëpunuese

Temat ndërkurrikulare kërkojnë përdorim të metodave të mësimdhënies që vendosin nxënësin në qendër të procesit: diskutime në grup, projekt, analizë rastesh, debate etj. Këto metoda i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë ndikimin e njohurive gjeografike në jetën reale dhe në shoqëri.

Bashkëpunimi me lëndët/fushat e tjera

Për një trajtim të suksesshëm ndërkurrikular, mësuesi i gjeografisë mund të bashkëpunojë me mësues të tjerë (p.sh. të biologjisë, historisë, qytetarisë, TIK-ut etj.), për të planifikuar projekte të përbashkëta që zhvillojnë kuptimin e temës nga këndvështrime të ndryshme.

Përshtatja me moshën dhe nivelin e nxënësve

Përzgjedhja e temave ndërkurrikulare dhe mënyra e trajtimit të tyre duhet të jetë në përputhje me moshën, përvojën dhe nivelin e zhvillimit të nxënësve.

Vlerësimi gjithëpërfshirës


Gjatë trajtimit të temave ndërkurrikulare, mësuesi duhet të vlerësojë jo vetëm njohuritë faktike, por edhe mënyrën si nxënësi analizon, ndërvepron, argumenton dhe propozon zgjidhje për çështje reale.

Në mënyrë më të detajuar shembuj të veprimtarive praktike për zhvillimin e temave ndërkurrikulare do të përshkruhen në udhëzuesit kurrikularë lëndorë.

4.3 Kompetencat e lëndës së gjeografisë dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat e lëndës së gjeografisë përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që nxënësit duhet të zhvillojnë për të kuptuar, analizuar dhe interpretuar mjedisin gjeografik, shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, si edhe marrëdhëniet komplekse ndërmjet natyrës dhe shoqërisë.

Kompetencat kryesore të lëndës së gjeografisë janë:



Këto kompetenca ndihmojnë nxënësin:

- të kuptojë botën përreth dhe ndërveprimet komplekse midis natyrës dhe shoqërisë;
- të mendojë në mënyrë kritike dhe të analizojnë çështje globale si ndryshimet klimatike, urbanizimi, migracioni etj.;
- të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme në komunitet dhe në shoqëri.

Kompetencat e lëndës së gjeografisë ndërtohen në mënyrë të ndërlidhur me kompetencat kyçe dhe zhvillohen përmes:

- situatave reale të të nxënit;
- projekteve, vëzhgimeve dhe punës në terren;
- përdorimit të hartave dhe burimeve digjitale;
- zgjidhjes së problemeve konkrete.

Kompetencat e lëndës së gjeografisë zërthehen në rezultate të nxëni për secilën klasë.

Tabela 2: Kompetencat lëndore dhe rezultatet e të nxënit

Kompetencat e lëndës së gjeografisë që zhvillohen përmes tematikave	Përshkrimi i kompetencave	Rezultatet e të nxënit për kompetencat për klasën e dhjetë
<p>VËZHGIMI DHE HETIMI I DUKURIVE GJEOGRAFIKE</p>	<p>Kompetenca "Vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike" i referohet aftësisë së nxënësve për të vëzhguar, eksploruar dhe analizuar në mënyrë sistematike dukuritë gjeografike që ndodhin në hapësirën gjeografike. Nxënësit aftësohen të përdorin mjetet gjeografike si harta, fotografi ajrore, imazhe satelitore, të dhëna statistikore, teknologjinë etj., për të hetuar dhe kuptuar ndryshimet që ndodhin në mjedisin gjeografik. Ata kuptojnë lidhjen shkak – pasojë të dukurive gjeografike, ndër lidhjen dhe ndikimin e tyre në hapësirë dhe kohë. Kjo kompetencë i ndihmon nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësinë për të kuptuar botën me një qasje më të thellë dhe të përgjegjshme.</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - identifikon dhe përshkruan dukuri gjeografike përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë, burimeve të ndryshme (harta, të dhëna statistikore, imazhe, dokumentarë etj.); - përdor metoda të thjeshta kërkimore (anketa, vrojtime, matje, krahasime) për të hetuar një dukuri gjeografike; - analizon marrëdhëniet ndërmjet faktorëve natyrorë dhe shoqërorë që ndikojnë në një dukuri të caktuar; - ndjek hapat bazë të procesit të hetimit gjeografik: përcaktimi i pyetjes kërkimore, mbledhja e të dhënave, përpunimi dhe paraqitja e rezultateve.
<p>MBLEDHJA, PËRPUNIMI DHE</p>	<p>Kompetenca "Mbledhja, përpunimi dhe komunikimi i informacionit gjeografik" i referohet aftësisë së nxënësve</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p>

<p>KOMUNIKIMI I INFORMACIONIT GJEORAFIK</p>	<p>për të kërkuar, mbledhur, përzgjedhur, vlerësuar dhe paraqitur informacion gjeografik nga burime të ndryshme, si libra, interneti, harta, statistika apo dokumente zyrtare. Nxënësit mësojnë si të përzgjedhin informacionin më të rëndësishëm, si ta kuptojnë dhe analizojnë atë, dhe si të dallojnë burimet e besueshme nga ato më pak të sigurta. Kompetenca përfshin aftësinë për të komunikuar informacionin gjeografik në mënyra të ndryshme: me gojë, me shkrim, nëpërmjet hartave, grafikëve, tabelave apo mjeteve digjitale. Kjo i ndihmon nxënësit të organizojnë më mirë dijet që marrin dhe t'i shprehin ato duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e duhur gjeografike.</p> <p>Në këtë mënyrë, ata bëhen përdorues aktivë të informacionit dhe zhvillojnë mendimin kritik për të kuptuar më mirë botën përreth tyre.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - kërkon dhe mblodh informacion nga burime të ndryshme (tekst, media digjitale, të dhëna statistikore, harta, intervista, platforma digjitale etj.); - vlerëson besueshmërinë dhe rëndësinë e informacionit të marrë nga burime të ndryshme; - përpunon informacionin e mbledhur dhe e organizon atë në forma të ndryshme (tabela, grafikë, prezantime etj.); - komunikon gjetjet përmes mjeteve të ndryshme (me gojë, me shkrim, vizualisht apo përmes teknologjisë), duke i përshtatur ato me audiencën dhe kontekstin.
<p>MARRJA E VENDIMEVE MBI BAZËN E</p>	<p>Kompetenca "Marrja e vendimeve mbi bazën e informacionit gjeografik" i referohet aftësisë për të analizuar situata dhe për të marrë vendime të arsyeshme bazuar në informacionin e mbledhur dhe analizuar. Duke</p>	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - analizon proceset dhe dukuritë gjeografike që ndodhin Tokë, ndikimin e tyre në mjedis, ekonomi dhe shoqëri, duke u mbështetur në informacionin e mbledhur;

<p>INFORMACIONIT GJEOGRAFIK</p>	<p>punuar me të dhëna reale dhe duke shqyrtuar pasoja të ndryshme të një vendimi, nxënësit zhvillojnë mendimin kritik dhe mësojnë të analizojnë situata nga këndvështrime të ndryshme. Ata kuptojnë se vendimet që merren, qoftë individualisht apo në nivel komuniteti, ndikojnë drejtpërdrejt në mjedisin përreth si dhe në jetën ekonomike dhe shoqërore. Kjo kompetencë i ndihmon nxënësit të rriten si qytetarë të ndërgjegjshëm dhe të angazhuar, të gatshëm për të marrë vendime të informuara që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit dhe në përmirësimin e jetës në shoqëri.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - vlerëson alternativa të ndryshme për zgjidhjen e problemeve të lidhura me mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm; - formulon qëndrime dhe sugjeron vendime të argumentuara për çështje gjeografike reale (si, p.sh., erozioni lumor, shkretëtirëzimi etj.). - reflekton mbi pasojat e mundshme të vendimeve individuale dhe kolektive në shkallë lokale dhe globale.
---	---	---

5 PËRMBAJTJA MËSIMORE DHE REZULTATET E TË NXËNIT

5.1 Koha mësimore për secilën tematikë/nëntematikë për klasën e dhjetë

Programi i gjeografisë për klasën X zhvillohet në 72 orë mësimore (2 orë mësimore/javë x 36 javë). Programi specifikon orët e sugjeruara për tematikë dhe nëntematikat. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat, projektin kurrikular, vëzhgimet në terren, testimet. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën nëntematikë.

Tabela 3: Orë të sugjeruara për tematikë dhe nëntematikat

Tematika	Nëntematikat	Orë mësimore të sugjeruara
Proceset natyrore dhe shoqërore	Sistemi diellor	10
	Hartografia	7
	Atmosfera	15
	Hidrosfera	8

	Litosfera	8
	Biosfera	2
	Dinamika e Tokës	18
	Mjedisi dhe ndikimi i veprimtarisë njerëzore	4
Totali i orëve mësimore vjetore		72

5.2 Përmbajtja e klasës së dhjetë

Në programin e gjeografisë për klasën e dhjetë janë paraqitur rezultatet e të nxënit për tematikën “Proceset natyrore dhe shoqërore” dhe nëntematikat e saj. Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Për secilën nëntematikë janë paraqitur njohuritë dhe aftësitë që duhet të demonstrojë nxënësi, ndërkohë që qëndrimet dhe vlerat që demonstroi nxënësi në lëndën e gjeografisë janë të përbashkëta për të gjitha nëntematikat.

Kombinimi dhe ndarja e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve).

5.2.1 TEMATIKA: PROCESSET NATYRORE DHE SHOQËRORE

Përshkrimi i tematikës:

Tematika “Proceset natyrore dhe shoqërore” zhvillon te nxënësit njohuri, shkathtësi dhe qëndrime në lidhje me kompleksitetin dhe dinamikën e proceseve dhe dukurive fiziko-gjeografike që ndodhin në Tokë. Nxënësi aftësohet të zbulojë dhe argumentojë lidhjet shkak-pasojë të dukurive dhe proceseve që ndodhin në sistemet natyrore të planetit tonë, të zhvillojë aftësi të kërkimit gjeografik përmes hulumtimit të tipareve dhe veçorive të sistemeve të Tokës, si dhe të ndërtojë gjykime dhe qëndrime në lidhje me perspektivat mjedisore. Nëpërmjet trajtimit të çështjeve aktuale, si ndryshimet klimatike dhe ndikimi i aktivitetit njerëzor, nxënësit zhvillojnë të menduarit kritik dhe ndërgjegjësimin qytetar, duke u aftësuar të marrin pjesë aktive dhe me përgjegjësi në debatet dhe veprimet për çështje të zhvillimit të qëndrueshëm.

Përmes detyrave praktike, projektit kurrikular dhe strategjive ndërvepruese të të nxënës, nxënësi aftësohet në kërkimin gjeografik dhe zhvillon të menduarin kritik dhe krijues. Përdorimi i teknologjisë së informacionit i ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi në komunikim, bashkëpunim dhe punë efektive në grup; përmes platformave digjitale, mjeteve vizuale dhe burimeve të ndryshme interaktive, ata aftësohen të kërkojnë, përpunojnë dhe paraqesin informacion në mënyrë të pavarur dhe krijuese. Duke përdorur burime të ndryshme, si harta, fotografi, statistika, diagrame, video dhe materiale vizuale, nxënësi zbulon dhe përvetëson koncepte gjeografike që lidhen me atmosferën, hidrosferën, litosferën dhe biosferën, si dhe me ndryshimet që ndodhin në Tokë për shkak të forcave të brendshme dhe të jashtme. Përpunimi i të dhënave statistikore, si dhe ndërtimi dhe interpretimi i diagrameve, grafikëve dhe hartave, ndihmon në zhvillimin e aftësive analitike, të të menduarit kritik dhe të të kuptuarit të informacionit në mënyrë të integruar, duke përforcuar lidhjet ndërmjet gjeografisë dhe fushave të tjera kurrikulare.

REZULTATET E TË NXËNIT

NËNTEMATIKA: SISTEMI DIELLOR

Njohuritë	Aftësitë
<ul style="list-style-type: none"> • Hipoteza e formimit të sistemit diellor • Dielli dhe karakteristikat e tij: <ul style="list-style-type: none"> -Përmasat -Struktura -Shtresat • Rëndësia e Diellit për dukuritë gjeografike • Toka si planet dhe tiparet e saj: <ul style="list-style-type: none"> -Forma -Përmasat • Evolucionin e mendimit gjeografik mbi formën dhe pozicionin e Tokës në sistemin diellor • Rrotullimi i Tokës rreth boshtit: Provat dhe pasojat • Rrotullimi i Tokës rreth Diellit, pasojat. • Hëna si trup qiellor e satelit natyror i Tokës: <ul style="list-style-type: none"> -Struktura -Fazat e Hënës 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • jep argumente që mbështesin hipotezën e formimit të sistemit diellor; • përshkruan strukturën e Diellit dhe karakteristikat kryesore të shtresave të tij; • vlerëson rëndësinë e Diellit për qarkullimin e përhershëm të ujit, ajrit, zhvillimin e botës bimore e shtazore etj.; • përpunon dhe prezanton të dhëna për Tokën si planet; • përshkruan evolucionin e mendimit gjeografik mbi formën dhe pozicionin e Tokës në sistemin diellor; • diferencon pasojat e rrotullimit të Tokës rreth vetes dhe qarkullimit rreth Diellit; • përshkruan Hënën dhe strukturën e saj; • demonstron skematikisht varësinë (lidhjen) e fazave të Hënës nga pozicioni relativ i Diellit, Hënës dhe Tokës;

<p>-Hipotezat e formimit të saj</p> <ul style="list-style-type: none"> • Eklipsi i Hënës dhe i Diellit • Planetët, asteroidet, meteorët, kometat • Zhvillimi i teknologjisë dhe eksplorimi i hapësirës 	<ul style="list-style-type: none"> • jep argumente në lidhje me hipotezat e formimit të Hënës; • krahason eklipsin e Diellit dhe të Hënës; • dallon planetët e brendshëm, të jashtëm, e satelitët e tyre, duke përshkruar disa ndër karakteristikat dalluese; • përshkruan kometat, asteroidët, meteorët dhe veçoritë e tyre; • sjell fakte dhe interpreton arritjet e shkencës dhe teknologjisë për eksplorimin e hapësirës.
---	--

NËNTEMATIKA: HARTOGRAFIA

<ul style="list-style-type: none"> • Paraqitja e Tokës në hartë, glob dhe plan • Rrjeti gjeografik • Brezat e kohës dhe përcaktimi i kohës lokale dhe zonale • Projektionet hartografike • Hartat, elementët matematikorë dhe gjeografikë 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • krahason mënyrat e ndryshme të paraqitjes së Tokës në hartë, glob dhe plan; • analizon ndërtimin e rrjetit gjeografik; • shpjegon ndryshimin e kohës lokale dhe zonale përmes përlllogaritjeve të tyre për vende me gjatësi të ndryshme gjeografike; • diferencon llojet e ndryshme të projeksioneve hartografikë;
--	--

<ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi i hartave sipas: <ul style="list-style-type: none"> - Përmbajtjes - Shkallës - Përdorimit mbi bazën e veçorive dalluese • Zhvillimet teknologjike dhe hartografia në ditët e sotme 	<ul style="list-style-type: none"> - klasifikon hartat sipas përmbajtjes, shkallës, dhe përdorimit mbi bazën e veçorive dalluese; - analizon elementet matematikorë dhe gjeografikë të hartës dhe përdorimin e tyre; - përcakton vendndodhjen e objekteve në hartë përmes përdorimit të platformave digjitale, si Google Maps, Google Earth etj.; - ndërton dhe interpreton profilin topografik të një sipërfaqeje të paraqitur në hartë; - diskuton për rolin dhe përdorimet e teknologjisë në zhvillimet e sotme hartografike, si p.sh përdorimin e GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik), GPS (Sistemi i Pozicionimit Global), imazheve satelitore, fotografive ajrore, platformave digjitale Google Maps, Google Earth etj.
---	---

NËNTEMATIKA: ATMOSFERA

<ul style="list-style-type: none"> • Hipoteza e formimit të atmosferës • Përbërja e atmosferës dhe karakteristikat kryesore të secilës shtresë • Rrezatimi diellor dhe llojet e tij • Ndikimi i rrezatimeve në sistemet gjeofizike të Tokës. 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • jep argumente që mbështesin hipotezën e formimit të atmosferës; • analizon ndërtimin shtresor të atmosferës dhe përbërjen e saj; • interpreton llojet e rrezatimeve (i drejtpërdrejtë, i shpërndarë, i përgjithshëm dhe i Tokës) dhe ndikimin e tyre në sistemet gjeofizike të Tokës;
--	--

<ul style="list-style-type: none"> • Temperatura e ajrit dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë • Lagështira e ajrit: kondensimi dhe format kryesore të tij • Reshjet dhe kushtet e formimit të tyre • Shpërndarja gjeografike e reshjeve dhe rëndësia e tyre • Trysnia atmosferike dhe ndryshimet e saj në kohë dhe në hapësirë 	<ul style="list-style-type: none"> • evidenton faktorët që ndikojnë në sasinë e rrezatimit që mbërrin në sipërfaqen e Tokës; • analizon ndryshimin në kohë të temperaturës (temperaturën mesatare ditore, mujore, vjetore, amplitudat) përmes llogaritjes dhe përpunimit të treguesve të temperaturës; • analizon ndryshimin e temperaturës në hapësirë (horizontal dhe vertikal) dhe faktorët që ndikojnë në të; • nxjerr përfundime mbi shpërndarjen e temperaturave duke analizuar hartën e izotermave; • demonstroi ndryshimin ndërmjet aparaturave të ndryshme për matjen e temperaturës (termometri maksimal, minimal, termografi); • interpreton ndryshimin ndërmjet lagështirës absolute dhe relative të ajrit. • shpjegon formimin e vesës, mjegullës, brymës dhe reve, përmes procesit të kondensimit; • shpjegon kushtet e formimit të llojeve të ndryshme të reshjeve; • ndërton dhe interpreton grafikë të shpërndarjes hapësinore dhe kohore të reshjeve; • vlerëson rëndësinë gjeografike të reshjeve; • analizon ndryshimin e trysnisë atmosferike në kohë dhe në hapësirë;
---	---

<ul style="list-style-type: none"> • Erërat dhe llojet e tyre: erërat e qarkullimit të përgjithshëm dhe erërat lokale • Masat ajrore dhe frontet • Ciklonet dhe anticiklonet • Moti, klima dhe faktorët që ndikojnë në formimin e saj • Zonat klimatike • Ndryshimet klimatike, faktorët që ndikojnë, politikat dhe masat për kontrollin e tyre 	<ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përdorimin e shkallës barometrike; • analizoi faktorët kryesorë që përcaktojnë drejtimin dhe shpejtësinë e erës; • shpjegoi formimin e: <ul style="list-style-type: none"> - erërave të qarkullimit të përgjithshëm; - erërave lokale; • përshkruan masat ajrore dhe frontet; • bën dallimin midis ciklonit dhe anticiklonit; • shpjegoi ndikimin e regjimit ciklonik në gjerësitë mesatare; • bën dallimin midis motit dhe klimës; • analizoi faktorët që ndikojnë në formimin e klimës; • hulumtoi në burime të ndryshme informacioni mbi rolin e teknologjisë në parashikimin e dukurive ekstreme të motit si p.sh., përmbytjet, thatësitat etj.; • interpretoi hartat të ndryshme sinoptike të gjetura përmes përdorimit të teknologjisë; • përcaktoi zonat klimatike sipas gjerësisë gjeografike dhe përshkruan veçoritë e tyre; • përcaktoi faktorët kryesorë që ndikojnë në ndryshimet klimatike; • argumentoi përmes shembujve, pasojat mjedisore, sociale dhe ekonomike të ndryshimeve klimatike, ndërvarësinë e këtyre
---	--

	<p>ndryshimeve dhe rëndësinë e politikave menaxhuese në nivel kombëtar dhe global;</p> <ul style="list-style-type: none"> • krahason pasojat e ndryshimeve klimatike në Shqipëri me vende të tjera të Mesdheut dhe botës, duke kuptuar ndikimet e ndryshme lokale dhe globale; • përdor të dhëna klimatike (nga burime si p.sh., Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO, platforma Copernicus etj.) për të analizuar ecurinë e temperaturës, të reshjeve dhe të dukurive ekstreme të motit (p.sh., thatësira të tejkujtura, përmbytje për shkak të reshjeve të dendura, stuhi të fuqishme etj.) dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike në to.
--	--

NËNTEMATIKA: HIDROSFERA

<ul style="list-style-type: none"> • Hidrosfera dhe ndërvarësia me pjesët e tjera të gjeosistemit • Ujërat e deteve dhe oqeanëve, dinamika e tyre (valët detare, baticat-zbaticat, rrymat oqeanike) 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përmes shembujve lidhjen dhe varësinë e hidrosferës me atmosferën, litosferën dhe biosferën; • identifikoi vetitë fizike e kimike të ujit të oqeanëve dhe deteve; • shpjegoi mënyrën e formimit të valëve detare; • identifikoi elementët e valës detare; • analizoi formimin e baticave dhe zbaticave e pasojat e tyre;
---	--

<ul style="list-style-type: none"> • Lumenjtë dhe regjimi i tyre hidrologjik • Liqenet, klasifikimi dhe evolucioni i tyre • Ujërat nëntokësorë, llojet e tyre dhe shfrytëzimi <ul style="list-style-type: none"> - Ujërat minerale, termominerale dhe rëndësia e tyre • Bora e përhershme dhe akullnajat 	<ul style="list-style-type: none"> • vlerëson shfrytëzimin e energjisë së baticave dhe zbaticave si burim alternativ i energjisë; • analizon rrymat oqeanike: <ul style="list-style-type: none"> - lëvizjen; - faktorët që ndikojnë në formimin e tyre; - llojet e tyre; - rëndësinë e tyre për klimën dhe jetën në Tokë; • interpreton karakteristikat kryesore të pjesëve përbërëse të lumit; • analizon regjimin hidrologjik të lumenjve; • analizon liqenet sipas origjinës së formimit të tyre shoqëruar me shembuj konkretë; • identifikon faktorët që ndikojnë në shndërrimin e liqeneve në kënetë; • interpreton mënyrën e formimit të ujërave nëntokësorë dhe llojet e tyre; • identifikon llojet e ndryshme të burimeve; • vlerëson rëndësinë e burimeve dhe të shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujërave nëntokësorë; • shpjegon kushtet e formimit të borës së përhershme dhe akullnajave; • diferencon akullnajat malore dhe kontinentale; • diskuton mbi shkrirjen e akullnajave, pasojat në gjeosistem dhe në veprimtarinë njerëzore;
--	--

<ul style="list-style-type: none"> Rëndësia e hidrografisë për zhvillimin e një rajoni/vendi 	<ul style="list-style-type: none"> hulumton mbi rolin e hidrografisë në aspektet natyrore dhe zhvillimin ekonomik (p.sh., të rajonit ku banon, vendit etj.).
NËNTEMATIKA: LITOSFERA	
<ul style="list-style-type: none"> Ndërtimi i brendshëm i Tokës dhe veçoritë e shtresave të saj Ndryshimet e temperaturës, trysnisë, dendësisë dhe magnetizmit Mineralet, vetitë fizike dhe përdorimet e tyre Llojet e shkëmbinjve dhe formimi i tyre Formimi i fosileve dhe rëndësia e tyre dokumentuese 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> diferencon shtresat e Tokës përmes veçorive tipike të secilës prej tyre; shpjegon ndryshimin e: <ul style="list-style-type: none"> temperaturës trysnisë dendësisë, në brendësi të Tokës; identifikon vetitë fizike të mineraleve dhe përdorimet e tyre; klasifikon llojet kryesore të shkëmbinjve (magmatikë, sedimentarë, metamorfikë). përshkruan kushtet e formimit të tyre; vlerëson rëndësinë gjeografike dhe ekonomike të shkëmbinjve; bën dallimin ndërmjet moshës absolute dhe relative të shkëmbinjve; interpretin rëndësinë e formimit të fosileve për dokumentimin e ngjarjeve dhe dukurive dhe mënyrën e formimit të tyre;

<ul style="list-style-type: none"> • Koha gjeologjike dhe evolucioni i botës së gjallë përgjatë saj 	<ul style="list-style-type: none"> • përdor ndarjen e kohës gjeologjike në era e periudha për të interpretuar evolucionin e botës së gjallë.
NËNTEMATIKA: BIOSFERA	
<ul style="list-style-type: none"> • Biosfera, elementët përbërës të saj dhe faktorët që ndikojnë në zhvillimin e botës organike • Roli i biosferës në mjedisin gjeografik 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon faktorët që ndikojnë në zhvillimin e botës organike; • vlerëson rolin e biosferës në mjedisin gjeografik; • hulumton mbi veçoritë dalluese të bimësisë në rajonin e tij.
NËNTEMATIKA: DINAMIKA E TOKËS	
<ul style="list-style-type: none"> • Pllakat tektonike, lëvizja e tyre dhe forcat lëvizëse • Krijimi i topografisë së sipërfaqes së Tokës dhe dyshemesë së oqeanit përmes tektonikës së pllakave • Lëvizjet luhatëse, rrudhosëse e shkëputëse dhe pasojat e tyre • Tërmetet dhe dukuria e formimit të tyre • Tipet e tërmeteve dhe pasojat e tyre 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon shpërndarjen e pllakave tektonike dhe lëvizjen e tyre; • sjell argumente pro/kundër tektonikës së pllakave; • përdor tektonikën e pllakave për të shpjeguar ndryshimin e topografisë së sipërfaqes së Tokës dhe dyshemesë së oqeanit; • përshkruan relievin e fundit të oqeanit; • analizon shkaqet e lëvizjeve luhatëse, rrudhosëse e shkëputëse dhe pasojat e tyre; • shpjegon dukurinë e formimit të tërmeteve; • diferencon tipet e tërmeteve sipas thellësisë dhe origjinës;

<ul style="list-style-type: none"> • Shpërndarja gjeografike e tërmeteve • Vullkanet, shpërndarja gjeografike e tyre dhe pasojat e vullkaneve • Llojet e shpërthimeve vullkanike • Forcat e jashtme dhe ndikimi i tyre në ndryshimet në Tokë • Tjetërsimi fizik, kimik e biologjik dhe kushtet në të cilat ndodhin • Dherat dhe faktorët e formimit të tyre • Dukuritë gravitative dhe faktorët e ndodhjes së tyre (shembjet, rrëzimet, rrëshqitjet) 	<ul style="list-style-type: none"> • përdor hartën dhe teknologjinë për të lokalizuar shpërndarjen gjeografike të tërmeteve; • diskuton mbi pasojat e tërmeteve përmes shembujve nga vendi e bota, masat për parandalimin e tyre dhe rolin e sizmologut; • analizon: <ul style="list-style-type: none"> - shkaqet e shpërthimit të vullkaneve; - pjesët e vullkaneve dhe produktet vullkanike; • diferencon llojet e shpërthimeve vullkanike dhe format që krijojnë; • përdor hartën dhe teknologjinë për të lokalizuar shpërndarjen gjeografike të vullkaneve; • diskuton mbi rrjedhojat e shpërthimeve vullkanike përmes shembujve; • analizon: <ul style="list-style-type: none"> - kushtet në të cilat ndodh tjetërsimi fizik, kimik e biologjik; - ndikimin e tjetërsimit në ndryshimin e sipërfaqes së Tokës; • identifikon: <ul style="list-style-type: none"> - shtresat e dheut dhe veçoritë e tyre; - faktorët që ndikojnë në formimin e dherave; - përhapjen gjeografike të tyre; • analizon kushtet në të cilat ndodhin shembjet, rrëzimet dhe rrëshqitjet;
---	--

<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria gjërryese, transportuese dhe depozituese e: <ul style="list-style-type: none"> - erës dhe format e relievit që krijohen prej saj; - ujërave rrjedhës dhe format e relievit që ato krijojnë; - karstit dhe format që krijohen; - akullnajave dhe format e relievit që ato krijojnë; - detit dhe format e relievit që krijohen prej saj. 	<ul style="list-style-type: none"> • diskuton mbi ndikimin e gravitetit në relievin e vendit tonë; • analizon veprimtarinë gjërryese, transportuese dhe depozituese të: <ul style="list-style-type: none"> - erës, - ujërave rrjedhës, - karstit, - akullnajave, - detit; • diskuton mbi shfrytëzimin e energjisë së erës si burim alternativ i qëndrueshëm energjistik, duke vlerësuar përfitimet dhe kufizimet e saj; • hulumton mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në intensifikimin e proceseve natyrore si rrëshqitjet, erozioni, shkretëtirëzimi etj.
--	---

NËNTEMATIKA: MJEDISI DHE NDIKIMI I VEPRIMTARISË NJERËZORE

<ul style="list-style-type: none"> • Mjedisi gjeografik dhe ndikimi i tij në veprimtarinë njerëzore • Roli i veprimtarisë njerëzore për ndryshimin e mjedisit • Zhvillimi i qëndrueshëm dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore 	<p><i>Nxënësi:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • analizon ndikimin e veprimtarisë njerëzore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas; • identifikon mënyra të menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore;
--	--

- hulumton mbi shkaqet dhe pasojat e keq menaxhimit të burimeve natyrore përmes shembujve;
- propozon alternativa dhe strategji të mundshme të mbrojtjes dhe përdorimit racional të burimeve natyrore.

Qëndrimet/vlerat

Nxënësi:

- tregon vlerësim dhe kureshtje për mjedisin natyror dhe shoqëror, duke kuptuar marrëdhëniet mes natyrës dhe shoqërisë;
- respekton diversitetin natyror dhe kulturor, si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë kombëtare dhe botërore;
- tregon gatishmëri për të bashkëpunuar dhe kontribuar në mënyrë konstruktive në punë në grup, duke vlerësuar idetë dhe përpjekjet e të tjerëve;
- shpreh interes për të eksploruar zgjidhje për sfidat mjedisore, duke treguar mendim të pavarur dhe të arsyetuar;
- zhvillon ndjeshmëri ndaj ndryshimeve klimatike dhe pasojave të tyre, dhe angazhohet në sjellje që mbështesin qëndrueshmërinë mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
- përdor me kujdes informacionin shkencor dhe burimet e të dhënave, dhe angazhohet në kërkime të përgjegjshme;
- reflekton në mënyrë kritike mbi të nxënësit dhe përvojat e veta, duke kërkuar përmirësim dhe zhvillim personal;
- vlerëson rolin e gjeografisë në jetën e përditshme dhe në orientimin profesional, duke kërkuar mënyra për të lidhur njohuritë me karrierat e mundshme në të ardhmen;
- komunikon lirshëm dhe me siguri mendimet, idetë dhe interpretimet personale gjatë veprimtarive;
- tregon interes për të eksploruar dhe analizuar harta të ndryshme tematike (si harta fizike, administrative etj.), duke zhvilluar aftësi për orientim dhe interpretim hapësinor;

- respekton dhe vlerëson pikëpamjet, përvojat dhe informacionin që ndajnë shokët e klasës apo burime të tjera, duke treguar ndjeshmëri ndaj të ndryshmes;
- tregon përkujdesje dhe ndjeshmëri ndaj mjedisit, duke marrë pjesë në veprime konkrete për mbrojtjen dhe ruajtjen e burimeve natyrore si uji, ajri, toka dhe biodiversiteti;
- vlerëson në mënyrë objektive rezultatet e vëzhgimeve apo kërkimeve të veta dhe i krahason ato me rezultatet e shokëve, duke pranuar kritikën pozitive dhe mësuar prej tyre;
- zbaton me përgjegjësi rregullat e sigurisë digjitale, sidomos gjatë përdorimit të teknologjisë së informacionit në kërkime gjeografike, duke shmangur faqet e pasigurta, mbrojtur të dhënat personale dhe kërkuar ndihmë në rast nevojë.

5.3 Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të veprimtarive që mund të përdoren nga mësuesi në përmbushje të rezultateve të të nxënit (RN-ve) në tematika të ndryshme.

Tabela 4. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve

Rezultatet e të nxënit	Shembuj të veprimtarive mësimore praktike
<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi shpjegon ndryshimin e kohës lokale dhe zonale përmes përlllogaritjeve të tyre për vende me gjatësi të ndryshme gjeografike. 	<p>Veprimtari: Udhëtim në kohë dhe vende të ndryshme</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fillimisht mësuesi mund të nxisë me nxënësit diskutimin rreth pyetjes: Nëse do të udhëtoni me avion nga Tirana në Tokio, do të ishte ora në Tokio e njëjtë me orën në Tiranë në momentin që do të mbërrinin atje?”

- Pasi prezantohet koncepti i brezave ose zonave të kohës dhe rëndësisë së tyre në jetën e përditshme, kalohet në veprimtarinë e mëposhtme.
- Mësuesi ndan klasën në 4-5 grupe nxënësish.
- Çdo grup merr një situatë të përgatitur nga mësuesi që kërkon përlllogaritje të ndryshimit të orës midis vendeve me gjatësi të ndryshme gjeografike.

Situata 1: Familja X në Boston (SHBA) dëshiron të telefonojë gjyshërit në Tiranë në orën 8:00 të mëngjesit (me orën lokale të Bostonit). A është kohë e përshtatshme për t'i telefonuar? Nxënësit argumentojnë përgjigjen e tyre.

Situata 2: Tre biznesmenë, nga Tokio, Londër dhe Nju Jork, duhet të zhvillojnë një takim online. Cila mund të ishte ora më e përshtatshme për të tre? Nxënësit argumentojnë përgjigjen.

Situata 3: Një avion nis nga Dubai në orën 15:00 (ora lokale e Dubait) dhe udhëtimi zgjat 7 orë. Detyra është të gjendet ora e mbërritjes në Paris, sipas orës lokale të Parisit.

Situata 4: Një nxënës që jeton në Los Anxhelos dëshiron të ndjekë një kurs online që transmetohet në orën 18:00 me orën e Berlinit. Në çfarë ore lokale në Los Anxhelos duhet të lidhet nxënësi për të ndjekur kursin në kohë?

	<ul style="list-style-type: none"> - Më pas nxënësit diskutojnë rreth përlogaritjes së kohës për vende me gjatësi të ndryshme gjeografike, pse është e rëndësishme, çfarë problemesh mund të shkaktojnë gabimet në përlogaritje, roli i teknologjisë moderne etj.
<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi analizon shpërndarjen e pllakave tektonike dhe lëvizjen e tyre. • Nxënësi sjell argumente pro/kundër tektonikës së pllakave. 	<p>Veprimtaria: Pllakat që lëvizin dhe formojnë Tokën</p> <ul style="list-style-type: none"> - Veprimtaria mund të fillojë me një modelim të thjeshtë të lëvizjes së pllakave tektonike. Nxënësit krijojnë me copa kartoni pllakat kryesore tektonike duke emërtuar secilën prej tyre (p.sh. pllaka Euro aziatike, Afrikane, e Paqësorit etj.). Nxënësit vendosin pllakat në tavolinë duke simuluar pozicionin e tyre mbi Tokë. Me anë të lëvizjeve të dorës demonstrojnë: <ul style="list-style-type: none"> ○ ndërveprimin konvergjent (përplasjen e pllakave) ○ divergjencën (largimin e pllakave) ○ lëvizjen anësore (rrëshqitjen pranë njëra-tjetrës) - Nxënësit diskutojnë për shkaqet dhe pasojat e këtyre lëvizjeve (tërmetet, vullkanet, formimi i maleve etj.). - Më pas, mësuesi e organizon klasën në dy grupe debati: <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>Grupi “Pro”</i>: Mbledh argumente dhe prova që mbështesin teorinë e tektonikës së pllakave si p.sh., përputhja e kontinenteve, shkëmbinj të ngjashëm në kontinente të ndryshme, shpërthimet vullkanike, tërmetet.

- Grupi “Kundër”: Paraqet dilemat dhe kundërshtimet historike ose bashkëkohore si p.sh., mungesa e mekanizmit të qartë për lëvizjen e pllakave në fillimet e teorisë, mospërputhje në disa zona etj.
- Më pas mësuesi zhvillon një diskutim të përbashkët rreth pyetjeve:
 - Si ndryshon jeta njerëzore në zonat ku pllakat takohen?
 - Çfarë dëmi mund të sjellin lëvizjet tektonike dhe si mund të parandalohen?
 - Pse është e rëndësishme të kuptojmë tektonikën e pllakave?

Më poshtë janë përshkruar disa shembuj veprimtarish¹ për nëntematika të ndryshme:

a) Nëntematika: Atmosfera

- *Veprimtaria: “Në gjurmët e klimës – Nga të dhënat, tek faktet”*

Nxënësve u kërkohet të mbledhin të dhëna nga burime të mundshme, si p.sh., Copernicus Climate Data Store, <https://science.nasa.gov/climate-change/>, [Instituti i Gjeoshkencave, IGJEO – Albania](#) etj., ose të dhëna të përzgjedhura të përgatitura nga mësuesi.

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup përzgjedh një periudhë dhe zonë (p.sh. Shqipëri – 1990–2024).

Çdo grup analizon:

- ecurinë e temperaturave mesatare vjetore;
- ecurinë e reshjeve vjetore;
- shpeshtësinë ose frekuencën e dukurive ekstreme klimatike (p.sh. ditë me temperatura mbi 40°C, përmbytje të mëdha, thatësira etj.).

¹ Shembujt e veprimtarive nuk janë detyruese për mësuesin dhe përdoruesit e tjerë të programit. Mësuesi është i lirë të përzgjedhë të zhvillojë me nxënësit nga këto veprimtari ose veprimtari të tjera, në përshtatje dhe me kontekstin e klasës.

Grupet përpunojnë informacionin në formë:

- Grafiku (rënie/ngritje e temperaturave ose reshjeve).
- Tabelë krahasimi (p.sh. mes viteve të thata dhe me reshje ekstreme).
- Përmbledhje e dukurive të motit ekstrem për periudha të caktuara.

Më pas vijohet me diskutimin në klasë “Po ndryshon klima... po ne?”. Diskutimi orientohet përmes pyetjeve:

- Si kanë ndryshuar temperaturat dhe reshjet në 30 vitet e fundit?
- Çfarë lidhje ka kjo me ndryshimet klimatike globale?
- A po ndodhin më shpesh dukuritë ekstreme? Cilat janë pasojat?
- Si mund të përgatitemi ose të përshtatemi si shoqëri?

Në përfundim, nxënësit përgatisin posterin ose prezantimin i cili mund të përfshijë:

- Një grafik dhe përmbledhje të gjetjeve
- Një mesazh sensibilizues për publikun (shkollën, komunitetin)

Posterat mund të ekspozohen në klasë ose në shkollë.

Kjo veprimtari mund të zhvillohet dhe në formën e një projekti kurrikular, lëndor ose ndër-lëndor.

b) Nëntematika: Hidrografia

- Veprimtaria: “Rrymat që lëvizin botën – Nga oqeanet te klima”

Mësuesi e fillon veprimtarinë me një diskutim: Pse lëviz uji në oqeanet? Mësuesi udhëzon nxënësit të përmendin shkaqet që mund të bëjnë që uji të lëvizë.

Më pas vijohet me eksperimentin praktik: “Rryma në gotë”. Për të zhvilluar këtë eksperiment, nevojiten: 1 gotë e tejdukshme uji, ujë i nxehtë me ngjyrë të kuqe, ujë i ftohtë me ngjyrë blu, pipetë ose shiringë.

Nxënësit udhëzohen të hedhin ujë të nxehtë ngadalë në njërën anë të gotës dhe ujin e ftohtë në anën tjetër. Ata vëzhgojnë si qarkullojnë ngjyrat, simulimi i rrymave të ngrohta që ngrihen dhe të ftohtat që zhyten. Mësuesi saktëson përgjigjet e nxënësve dhe shpjegon faktorët kryesorë që ndikojnë në rrymat oqeanike.

Mësuesi prezanton një hartë të thjeshtuar të oqeanëve me shigjeta për rrymat kryesore. Nxënësit punojnë në grupe për të analizuar:

<i>Rryma</i>	<i>Lloji (e ngrohtë/e ftohtë)</i>	<i>Lëvizja</i>	<i>Ndikimi në klimë</i>
P.sh., Golfstrimi	E ngrohtë	Nga Gjiri i Meksikës në Evropën Veriore	Ngroh klimën e Evropës Perëndimore

Mësuesi mund ta organizojë dhe në grupe këtë pjesë të veprimtarisë duke i caktuar secilit grup, një nga rrymat oqeanike për të cilën do të përshkruajnë:

- Nga nis dhe ku shkon?
- Çfarë ndikon gjatë rrugëtimit?
- Çfarë temperaturash dhe vendesh përshkon?
- Si ndikon në klimën e zonave që përshkon?
- Si do të ndikohej klima në mungesë të saj?

c) Nëntematika: Dinamika e Tokës

- *Veprimtaria: “Vullkanet – Fuqia e zjarrtë e Tokës”*

Mësuesi fillon veprimtarinë me një diskutim: Çfarë ndodh nën Tokë? Mësuesi udhëheq bisedën duke pyetur nxënësit: Pse mendojnë se vullkanet shpërthejnë? Nga vjen zjarri dhe llava?

Më pas kalohet në modelimin “Ndërtimi i vullkanit”. Nxënësit ndërtojnë një model të vullkanit me argjilë të grumbulluar rreth një shisheje. Shtojnë sodë buke dhe uthull brenda shishes, duke shkaktuar një “shpërthim” të ngjashëm me rrjedhje llave. Diskutohen shkaqet që shkaktuan “shpërthimin”. Mësuesi bën kujdes për masat e sigurisë gjatë eksperimentit.

Në vazhdim të veprimtarisë mësuesi prezanton diagramin e vullkanit ku shpjegon pjesët kryesore të tij. Nxënësve u kërkohet të identifikojnë produktet që dalin nga vullkani.

Veprimtaria mund të mbyllet më një diskutim për rolin e vullkaneve në Tokë:

- Si ndihmojnë vullkanet në krijimin e tokës pjellore?
- Si ndikojnë ato në klimën lokale dhe globale?
- A ka njerëz që jetojnë pranë vullkaneve? Pse?

Në udhëzuesit kurrikularë për lëndën e gjeografisë do të përshkruhen në mënyrë të detajuar shembuj të veprimtarive praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënësve sipas tematikave të lëndës.

6 METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies në lëndën e gjeografisë luajnë një rol kyç në krijimin e një mjedisi të pasur dhe efikas mësimor, që mbështet zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Ato kontribuojnë në nxitjen e interesit për të mësuar, promovimin e bashkëpunimit në klasë dhe në zhvillimin e aftësive analitike dhe kërkimore. Përzgjedhja e metodave dhe teknikave duhet të jetë e mirë peshuar dhe e përshtatur me veçoritë individuale të nxënësve, duke marrë parasysh stilet e tyre të të nxënit.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies në gjeografi duhet të jenë të larmishme dhe të përshtatura për të stimuluar dhe përmirësuar të nxënit e nxënësve.

Mësimdhënia e gjeografisë në klasën e X kërkon një qasje dinamike dhe ndërdisiplinore, e cila nxit të menduarit kritik, aftësitë kërkimore dhe ndërgjegjësimin për çështjet mjedisore dhe globale. Në këtë fazë zhvillimi, nxënësit janë në gjendje të analizojnë marrëdhënie të ndërlikuara hapësinore dhe të shpjegojnë procese natyrore e shoqërore në mënyrë të argumentuar. Nxënësve u duhet të punojnë në situata (p.sh. përmbytje, thatësira etj.) ku kërkohet të analizojnë shkaqet dhe pasojat duke përdorur të dhëna gjeohapësinore dhe burime të ndryshme. Përdorimi i teknologjisë dhe platformave digjitale, që ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë lidhjet hapësinore dhe të interpretojnë të dhëna komplekse, është shumë efektiv.

Çfarë duhet të mbajë parasysh mësuesi në përzgjedhjen dhe përdorimin e metodave dhe teknikave të mësimdhënies:

- Përdorimi i metodave dhe strategjive të mësimdhënies duhet të marrë parasysh njohuritë dhe përvojat e mëparshme të nxënësve. Kjo do të ndihmojë në orientimin dhe mbështetje të procesit të të nxënit, duke siguruar që nxënësit të ndjehen të angazhuar dhe të motivuar për të mësuar.

- Gjeografia është një lëndë që kërkon një lidhje të ngushtë me mjedisin natyror dhe shoqëror. Mësuesi duhet të inkurajojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e vrojtimit dhe kërkimit përmes vëzhgimeve të drejtpërdrejta. Kjo mund të përfshijë vizita në terren (nëse është e mundur), studime të dukurive natyrore dhe shoqërore, si dhe përdorimin e hartave dhe mjeteve të tjera gjeografike.
- Nxënësit duhet të nxiten të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, duke përdorur analiza dhe kërkime për të zgjidhur probleme gjeografike. Kjo do t'i ndihmojë ata të zhvillojnë aftësi të menduarit logjik dhe të krijojnë lidhje mes dukurive natyrore dhe shoqërore që ndodhin në botë.
- Nxënësit duhet të trajtohen si partnerë në procesin mësimor. Mësuesi duhet të krijojë një atmosferë ku nxënësit janë të inkurajuar të angazhohen, të shprehin mendimet e tyre dhe të kontribuojnë në diskutime të hapura dhe konstruktive. Kjo do të ndihmojë në forcimin e ndërveprimit dhe bashkëpunimit ndërmjet nxënësve.
- Mësuesi duhet të ofrojë mundësi që nxënësit të zhvillojnë aftësi të nxënies të pavarur përmes punëve individuale dhe gjithashtu të punojnë në grupe për të zhvilluar aftësitë e bashkëpunimit. Kjo do të ndihmojë në përvetësimin e njohurive dhe zhvillimin e kompetencave në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe efikase.
- Mësimdhënia e gjeografisë duhet të theksojë lidhjet dhe integrimin ndërmjet fushave të tjera kurrikulare dhe lëndëve, si historia, qytetaria, shkencat e natyrës etj. Nxënësit duhet të kuptojnë se gjeografia është një lëndë që lidhet ngushtë me jetën e përditshme dhe me zhvillimin e shoqërisë, dhe se njohuritë gjeografike janë të rëndësishme për të kuptuar botën përreth.
- Mësuesi duhet të inkurajojë nxënësit të përdorin burime të shumta informacioni, përfshirë libra, artikuj shkencorë, internet, harta dhe mjete të tjera gjeografike. Teksti, megjithatë, duhet të shikohet si një burim i rëndësishëm, por jo i mjaftueshëm për përftimin e kompetencave të lëndës. Nxënësit duhet të përdorin një gamë të gjerë burimesh për të thelluar njohuritë e tyre.
- Teknologjia e informacionit dhe komunikimit është një mjet i fuqishëm që mund të mbështesë dhe lehtësojë mësimdhënien dhe të nxënies në gjeografi. Mësuesi mund të përdorë TIK për të krijuar mundësi mësimi ndërveprues dhe për të nxitur nxënësit në kërkime dhe eksplorime të ndryshme.

Roli i mësuesit konsiston në udhëheqjen e nxënësve; ai moderon kërkimin dhe eksplorimin e dukurive gjeografike. Mësuesit veprojnë si moderatorë midis dijes dhe nxënësit, duke e ndihmuar nxënësin të përfshihet në procesin e ndërtimit të dijes.

6.1 Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e gjeografisë

Roli i situatave të të nxënit praktike nga jeta reale në mësimin e gjeografisë është shumë i rëndësishëm, pasi ato mundësojnë që nxënësit të lidhen me dukuritë dhe përvojat që ndodhin përreth tyre. Ky lloj mësimi e bën gjeografinë më të kuptueshme dhe më të zbatueshme në jetën e përditshme. Përdorimi i situatave reale i mundëson nxënësve të zhvillojnë aftësi analitike dhe kritike, dhe gjithashtu ndihmon që ata të zhvillojnë një lidhje të drejtpërdrejtë me botën që i rrethon.

Përdorimi i situatave të të nxënit:

- *Përmirëson kuptimin e koncepteve të gjeografisë.* Situatat praktike ndihmojnë që nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet gjeografike duke i lidhur me përvojën konkrete.
- *Siguron lidhjen me jetën e përditshme.* Mësimi i gjeografisë që lidhet me situata praktike mund të ndihmojë nxënësit të kuptojnë ndikimin e dukurive gjeografike në jetën e përditshme, si për shembull, ndikimi i klimës në bujqësi ose mundësitë e zhvillimit të turizmit në zona të caktuara.
- *Nxit zhvillimin e aftësive analitike dhe kritike.* Situatat praktike ofrojnë mundësi për nxënësit që të analizojnë dhe të japin zgjidhje për probleme gjeografike që i hasin në jetën reale. Kjo mund të jetë ndihmuese në zhvillimin e aftësive për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve.
- *Ndihmon në zhvillimin e të menduarit krijues.* Kur nxënësit angazhohen me situata reale, ata mund të shohin mundësi të reja dhe krijuese për t'i adresuar këto sfida gjeografike.

6.2 Roli i projekteve kurrikulare në lëndën e gjeografisë

Projektet kurrikulare në lëndën e gjeografisë ofrojnë mundësi që nxënësit të angazhohen në mënyrë aktive me mësimin dhe të zbatojnë njohuritë e fituara përmes aktiviteteve praktike dhe krijuese. Projektet kurrikulare janë një mjet efikas për të zhvilluar aftësitë analitike, kritike dhe krijuese të nxënësve, për të forcuar lidhjen mes teorisë dhe praktikës dhe për të mundësuar integrimin ndërlëndor dhe me temat kroskurrikulare. Disa ndër aspektet kyçe të rolit të projekteve kurrikulare në mësimin e gjeografisë janë:

- *Projektet kurrikulare i mundësojnë nxënësve të kuptojnë dhe zbatojnë konceptet e mësuara në lëndën e gjeografisë, duke i lidhur ato me situata reale.*
- *Nëpërmjet projekteve kurrikulare, nxënësit zhvillojnë aftësi hulumtuese dhe analitike. Ata mësojnë të mbledhin të dhëna, të analizojnë informacionin dhe të formulojnë përfundime të mbështetura nga të dhëna. Për shembull, një projekt mbi "rrezikun e përmytjeve në një zonë të caktuar" mund të kërkojë që nxënësit të mbledhin të dhëna nga burime të ndryshme (raporte meteorologjike, studime të mëparshme etj.) dhe të analizojnë mundësitë e përmytjeve në atë rajon.*
- *Projekti kurrikular shpesh zhvillohet në grup, gjë që *nxit bashkëpunimin dhe zhvillon aftësitë sociale* të nxënësve. Ata mësojnë të punojnë së bashku, të diskutojnë idetë e tyre dhe të arrijnë konsensus për zgjidhje të ndryshme. Bashkëpunimi i grupit është një mundësi që nxënësit të ndajnë njohuritë dhe të krijojnë zgjidhje kolektive për çështje komplekse.*
- *Projekti kurrikular mund të ofrojë mundësi për mësim të diferencuar, ku nxënësit mund të angazhohen në mënyra të ndryshme, sipas interesave dhe aftësive të tyre. Disa mund të fokusohen më shumë në mbledhjen e të dhënave dhe analizën statistikore, ndërsa të tjerë mund të angazhohen më shumë në krijimin e një prezantimi për të komunikuar rezultatet e projektit.*
- *Projektet kurrikulare janë një mundësi që nxënësit të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve, pasi shpesh ata do të përballen me çështje dhe situata reale që kërkojnë zgjidhje të mundshme. Kjo ndihmon nxënësit të zhvillojnë të menduarit kritik dhe krijues, duke i ndihmuar ata të mendojnë për zgjidhje praktike për probleme gjeografike.*

- Përmes projekteve, nxënësit nxisin krijimtarinë dhe mund të zbatojnë ide të reja dhe inovative për të trajtuar tema gjeografike. Ata mund të krijojnë harta, prezantime vizuale, ose modele të ndryshme që përfaqësojnë të dhëna gjeografike, duke përdorur mjete dhe teknologji të ndryshme për të ilustruar dhe shpjeguar idetë e tyre.
- Përmes projekteve kurrikulare, nxënësit mund të përdorin teknologjinë për të mbledhur, analizuar dhe paraqitur informacionin gjeografik. Përdorimi i hartave interaktive ose aplikacioneve për analizimin dhe prezantimin e të dhënave mund të jetë një mjet efektiv për t'i përgatitur ata për përdorimin e teknologjisë në studimet dhe karrierat e ardhshme.
- Projekte kurrikulare rrisin motivimin dhe angazhimin e nxënësve, pasi ato krijojnë mundësi për zbatimin e njohurive në situata reale. Nxënësit mund të ndjehen më të lidhur me lëndën e gjeografisë kur ata shohin se çfarë mund të bëjnë me njohuritë që kanë fituar. Angazhimi në projekte konkrete ndihmon që procesi i të mësuarit të jetë më i gëzueshëm dhe interesant.

Shembull projekti: Në gjurmët e klimës “50 vjet ndryshim”

Duke përdorur burime si IGJEO, Copernicus ose të dhëna lokale, nxënësit mbledhin dhe analizojnë të dhëna për temperaturën, reshjet dhe ngjarjet ekstreme në një qytet të Shqipërisë ose të një vendi në botë për dekadat e fundit. Ata paraqesin të dhënat përmes grafikëve dhe përgatisin një prezantim ku tregojnë tendencat, ndikimet në bujqësi, jetesë dhe shëndet, si dhe japin sugjerime për veprim lokal dhe global ndaj ndryshimeve klimatike. Projekti forcon të menduarit kritik dhe përdorimin e të dhënave reale.

Shembull projekti: Lumenjtë – Burimi i jetës në vendin tim

Nxënësit zgjedhin një lumë të rëndësishëm të Shqipërisë ose rajonit (si p.sh., Drini, Vjosa, Semani) dhe realizojnë një poster ose broshurë informuese, ku përshkruajnë burimin e lumit, degët kryesore, rrjedhën, regjimin hidrologjik, përdorimet ekonomike dhe ndikimet mjedisore. Ata analizojnë gjithashtu ndonjë problem si ndotja, përmbytjet apo mungesa e ujit në periudha të caktuara. Projekti ndihmon nxënësit të kuptojnë rolin e lumenjve dhe të zhvillojnë ndjeshmëri për mbrojtjen e tyre.

6.3 Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë

Puna me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë kërkon një qasje të ndjeshme, fleksibël dhe individuale. Përdorimi i metodave të diferencuara, teknologjisë, dhe aktiviteteve të përshtatura është i nevojshëm për të siguruar që nxënësit të kenë mundësinë të zhvillohen dhe të përfshihen në mësimin e gjeografisë. Mbështetja e vazhdueshme, bashkëpunimi me prindërit dhe krijimi i një mjedisi mbështetës janë gjithashtu faktorë kyç për suksesin e nxënësve.

Më poshtë janë disa aspekte kyçe të punës me nxënësit me nevoja të veçanta në lëndën e gjeografisë:

a) Diferencimi i mësimdhënies dhe materialeve

Mësuesi duhet të diferencojë metodat e mësimdhënies për të siguruar që të gjithë nxënësit të përfshihen në mësim. Kjo mund të përfshijë:

- *Përdorimin e materialeve vizuale.* Harta, diagramet, fotografitë dhe videot mund të ndihmojnë nxënësit që të kuptojnë më mirë konceptet gjeografike.
- *Thjeshtëzimin e përmbajtjes.* Për nxënësit që kanë vështirësi në kuptimin e informacionit të ngjeshur, mësimi mund të thjeshtohet dhe të strukturohet në mënyrë që të jetë më i lehtë për t'u kuptuar.

b) Përshtatja e veprimtarive dhe detyrave

Veprimtaritë dhe detyrat në lëndën e gjeografisë mund të ndryshojnë për të përmbyshur nevojat e nxënësve me aftësi të ndryshme. Për shembull, nxënësit mund të punojnë në grupe të vogla, ku ata mund të mbështeten nga bashkëmoshatarët dhe të ndihmohen për të realizuar detyra të caktuara; disa nxënës mund të kenë nevojë për detyra më të thjeshta ose të tjera më vizuale, siç janë puna me hartat etj.

c) Mbështetja individuale dhe mbikëqyrja

Për nxënësit që kanë nevoja të veçanta, mund të jetë e nevojshme të ofrohet mbështetje e personalizuar gjatë mësimi. Mësuesi mund të ofrojë udhëzime të drejtpërdrejta dhe mbikëqyrje për t'i ndihmuar ata të kuptojnë materialin dhe të realizojnë detyrat e tyre. Nxënësit mund të kenë vështirësi të përballen me presionin e detyrave shkollore. Krijimi i një mjedisi mbështetës, ku ata ndjehen të sigurt dhe të motivuar, është shumë i rëndësishëm për suksesin e tyre. Puna në terren, studimi i hartave mund të kërkojnë mbikëqyrje të shtuar për nxënësit që kanë nevoja të veçanta, për t'u siguruar që ata po zhvillojnë veprimtaritë si duhet dhe që po përfitojnë nga mësimi.

d) Përfshirja e teknologjisë dhe mjeteve të përshtatshme

Përdorimi i teknologjisë mund të jetë shumë i dobishëm për nxënësit me nevoja të veçanta, pasi mund të ofrojë mundësi për të mësuar në mënyrë alternative dhe mund të jetë shumë më efektiv për individë që kanë vështirësi me materialet tradicionale. Aplikacione si Google Earth ose softuerë të tjerë mund t'u ofrojnë nxënësve mundësinë të eksplorojnë dhe të merren me gjeografinë në mënyrë më dinamike. Nxënësit me vështirësi të të kuptuarit të tekstit mund të përfitojnë nga videot edukative që shpjegojnë konceptet gjeografike në mënyrë të vizualizuar.

e) Vlerësimi dhe përshtatja e metodave të vlerësimit

Përshtatja e metodave të vlerësimit ndihmon në krijimin e një mjedisi të drejtë dhe të barabartë për nxënësit me nevoja të veçanta.

f) Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës

Një nga aspektet më të rëndësishme të punës me nxënësit me nevoja të veçanta është krijimi i një mjedisi të sigurt dhe mbështetës. Ky mjedis ndihmon që nxënësit të mos ndjehen të ndarë ose të izoluar, por të përfshirë në procesin e mësimi. Mësuesit duhet të jenë të kujdesshëm në ndihmën që ofrojnë, duke siguruar që të gjithë nxënësit të kenë mundësi të barabarta për të mësuar.

6.4 Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë

Puna me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë ka për qëllim të stimulojë zhvillimin e aftësive të tyre dhe të krijojë mundësi për t'i sfiduar më tej në drejtim të njohurive dhe kompetencave gjeografike. Nxënësit e talentuar shpesh shfaqin një interes të thellë dhe aftësi të shkëlqyera për të kuptuar dhe analizuar dukuritë gjeografike në një nivel më të lartë. Për të siguruar që këta nxënës të zhvillohen dhe të ruajnë nivelin e lartë të interesit dhe motivimit, është e rëndësishme që mësuesit të përdorin strategji të veçanta për t'i përfshirë ata në aktivitete të avancuara dhe për t'i sfiduar vazhdimisht.

Disa ndër strategjitë e mësimdhënies me nxënësit e talentuar në lëndën e gjeografisë përfshijnë:

- *Mësimdhënia e diferencuar* është një strategji e rëndësishme për t'u siguruar që nxënësit e talentuar të kenë mundësinë të thellojnë njohuritë e tyre. Për nxënësit e talentuar, mësuesi mund të ofrojë material që përfshin koncepte më të avancuara të gjeografisë; nxënësit mund të angazhohen në diskutime më komplekse dhe analiza të thelluara të çështjeve gjeografike; nxënësit mund të zhvillojnë projekte që kërkojnë hulumtime të thelluara mbi tema të zgjedhura nga ata.
- Nxënësit e talentuar mund të mësojnë të përdorin teknologji të avancuara për të analizuar të dhëna gjeografike dhe për të krijuar modele që mund të aplikohen në studimin e dukurive gjeografike.
- Nxënësit mund të angazhohen në aktivitete, si vizita në muze, pjesëmarrje në konkurse shkencore, ose angazhimi në projekte komuniteti që përfshijnë zgjidhjen e problemeve mjedisore.
- Nxënësit mund të marrin pjesë në konkurse që lidhen me gjeografinë, si olimpiadat e gjeografisë, ku mund të sfidohen me të tjerë dhe të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre.

Në udhëzuesin kurrikular për lëndën e gjeografisë do të përshkruhen në mënyrë të detajuar shembuj të veprimtarive praktike për zbatimin e metodave të mësimdhënies.

7 VLERËSIMI I NXËNËSVE

Vlerësimi është një pjesë thelbësore dhe integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënësve. Ai përfshin mbledhjen e informacioneve përmes teknikave të ndryshme të vlerësimit, të cilat ndihmojnë në matjen e arritjes së rezultateve të pritshme. Vlerësimi ka për qëllim të sigurojë një kuptim të qartë të progresit të nxënësve dhe të ofrojë informacione të vlefshme për përmirësimin e procesit mësimor. Me këtë informacion, mësuesi mund të marrë vendime të informuara për vlerësimin përfundimtar të nxënësve.

Përmes vlerësimit, mësuesi mund të përcaktojë nivelin e zhvillimit të njohurive dhe aftësive të nxënësve dhe të sigurojë që të gjitha metodat e mësimdhënies të përshtaten në mënyrë të tillë që të kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të mësimdhënies. Po ashtu, vlerësimi u shërben nxënësve për të identifikuar aspektet ku mund të përmirësohen dhe për të motivuar për të arritur nivele më të larta. Në të njëjtën kohë, prindërit përfitojnë nga ky informacion për të monitoruar progresin dhe zhvillimin e fëmijëve të tyre në shkollë, duke krijuar mundësi për mbështetje të vazhdueshme në shtëpi.

Mësuesit duhet të përdorin situata të jetës reale si pikënisje për vlerësimin e nxënësve në lëndën e gjeografisë. Kjo qasje mund të ndihmojë nxënësit të shohin se si njohuritë që po përvetësojnë mund të zbatohen në kontekste të jetës së përditshme. Përdorimi i konteksteve reale u ofron mundësi nxënësve të zhvillojnë aftësi analitike dhe praktike dhe i ndihmon ata të kuptojnë se gjeografia nuk është vetëm një disiplinë akademike, por një mjet i rëndësishëm për kuptimin dhe zgjidhjen e problemeve të botës reale.

Më poshtë përshkruhen disa ndër parimet kryesore të vlerësimit të nxënësve në lëndën e gjeografisë:

- *Vlerësimi duhet të jetë i drejtë, i paanshëm dhe i barabartë, duke u dhënë të gjithë nxënësve mundësinë për të demonstruar tërësinë e dijeve, aftësive dhe mundësive të tyre.*
- *Vlerësimi duhet të ofrojë informacion mbështetës për nxënësin.*

- *Vlerësimi duhet të ushqejë aftësitë e nxënësve për të transferuar dijet e tyre në përvoja jetësore.*
- *Vlerësimi duhet të nxisë pjesëmarrjen aktive dhe vetëvlerësimin e nxënësve për të reflektuar mbi të nxënit e tyre.*
- *Vlerësimi duhet të mundësojë shanse të barabarta për zhvillimin dhe përmirësimin e nxënësve.*
- *Vlerësimi duhet të përfshijë jo vetëm matjen, por dhe interpretimin e gjykimin.*
- *Vlerësimi duhet të jetë pjesë integrale e të gjithë orës së mësimin dhe jo një moment në fund të saj.*
- *Vlerësimi duhet t'u komunikohet rregullisht prindërve/kujdestarëve dhe nxënësve në një mënyrë sa më kuptimplotë.*

Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve për t'u vlerësuar në atë mënyrë që është më e përshtatshme për aftësitë dhe nevojat e tyre individuale.

Llojet e vlerësimit në lëndën e gjeografisë

➤ *Vlerësimi diagnostikues (Vlerësimi si proces i nxënies)*

Ky lloj vlerësimi kryhet në fillim të vitit shkollor ose në fillim të një njësie të re mësimore. Mësuesi përdor këtë lloj vlerësimi për të zbuluar njohuritë që nxënësi ka mbi temat e mëparshme dhe për të identifikuar aspektet që kanë nevojë për përmirësim.

Disa ndër teknikat që mund të përdoren për vlerësimin diagnostikues përfshijnë:

- Pyetje të thjeshta dhe të drejtpërdrejta për të kuptuar njohuritë paraprake të nxënësve.
- Ushtrime orientuese të shkurtra.
- Lojëra ose biseda reflektuese.
- Fisha vetëvlerësimi ku nxënësit reflektojnë mbi njohuritë dhe aftësitë e tyre të tanishme dhe identifikojnë fushat ku ndjehen më të dobët.

➤ *Vlerësimi formues (Vlerësimi i vazhduar, Vlerësimi për të nxënë)*

Ky vlerësim realizohet gjatë gjithë procesit mësimor, në çdo mësim, dhe ka për qëllim të monitorojë përparimin e nxënësve. Vlerësimi formues është një mundësi për të siguruar që nxënësit janë në rrugën e duhur dhe për të identifikuar çfarë duhet përmirësuar para se të arrihen rezultatet përfundimtare.

Disa ndër teknikat që mund të përdoren për vlerësimin formues përfshijnë:

- Vlerësimi i punës në grupe përmes aktiviteteve praktike si puna me hartat, analiza e situatave gjeografike, apo studime rastesh.
- Vëzhgimi i angazhimit dhe pjesëmarrjes gjatë mëimit.

- Detyrat dhe veprimtaritë përgjatë procesit mësimor.
- Vlerësimi i diskutimeve dhe argumentimit të zgjidhjeve.
- Vlerësimi i përgjigjeve gjatë mëimit, përmes pyetjeve që lidhen me konceptet gjeografike (p.sh., "Si ndikon erozioni i tokës në biodiversitet?").
- Vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga bashkëmoshatarët nëpërmjet analizave dhe diskutimeve të aktiviteteve gjeografike që zhvillohen gjatë mëimit.

➤ ***Vlerësimi përmbledhës*** (*Vlerësimi periodik, Vlerësimi i të nxënës*)

Ky lloj vlerësimi realizohet pas një periudhe mësimore ose pas përfundimit të një kapitulli dhe ka për qëllim të matë atë që nxënësi ka arritur të mësojë gjatë një periudhe. Ky lloj vlerësimi është shpesh i lidhur me notën finale të nxënësit dhe ndihmon për të kuptuar progresin e nxënësit dhe aftësitë që ka zhvilluar në lidhje me temat e gjeografisë.

Disa ndër teknikat që mund të përdoren për vlerësimin përmbledhës përfshijnë:

- Teste me shkrim.
- Detyra individuale.
- Prezantim i produkteve të projektit.
- Raporte dhe ese që kërkojnë përdorimin e njohurive të marra gjatë periudhës mësimore për të argumentuar për një temë të gjeografisë.

➤ Vlerësimi bazuar në nivele arritjeje

Vlerësimi bazuar në nivele arritje është një qasje thelbësore në mësimdhënien e gjeografisë; ndihmon në diferencimin e mësimdhënies dhe personalizimin e procesit të të nxënës për çdo nxënës.

Nivelet e arritjeve shprehin rezultatet e ndryshme që arrijnë nxënës të ndryshëm në përpjekjet e tyre për të përmbushur arritjen e dëshiruar (e pritshme) prej tyre në një lëndë. ***Për të përcaktuar nivelin e arritjes së nxënësit duhen bërë një sërë vëzhgimesh dhe duhen përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi të cilat duhet t'i shërbejnë progresit të nxënësit.***

Kjo do të thotë që mësuesi:

- të mundësojë situata të nxënës në përputhje me rezultatet e pritshme;
- të përzgjedhë veprimtari mësimore gjatë të cilave nxënësit demonstrojnë nivelin e tyre të arritjeve dhe i krijohet mundësi për progres;
- të vlerësojë nxënësit në përputhje me nivelet e tyre të arritjeve (performancën).

Në veçanti, nivelet e arritjeve ndihmojnë mësuesin për të planifikuar mësimdhënien individuale, punën e diferencuar me nxënësit, për të ndikuar pozitivisht në progresin e tij dhe për të raportuar të nxënësit e nxënësit.

7.1 Shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit.

Në këtë rubrikë paraqiten disa shembuj të niveleve të arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit në tematika të ndryshme.

Tabela 5. Shembull për nivelet e arritjes për vlerësimin e RN-ve

Shembull 1. Rezultati i të nxënit (RN): Analizon shpërndarjen e pllakave tektonike dhe lëvizjen e tyre			
Niveli i arritjes: Shumë mirë	Niveli i arritjes: Mirë	Niveli i arritjes: Mjaftueshëm	Niveli i arritjes: Dobët
Nxënësi tregon saktë shpërndarjen globale të pllakave tektonike kryesore në hartë; shpjegon në mënyrë të plotë dhe të saktë lëvizjet kryesore të pllakave (konvergjente, divergjente, transformuese); lidh qartë lëvizjen e pllakave me format e relievit dhe dukuritë sizmike e vullkanike; përdor terminologji të saktë shkencore dhe jep shembuj konkretë nga rajone të ndryshme të botës (p.sh. Rrethi i Zjarrtë, Himalajet etj).	Nxënësi identifikon shumicën e pllakave kryesore dhe përshkruan njohuri të përgjithshme për shpërndarjen e tyre; shpjegon drejt lëvizjet kryesore të pllakave me ndonjë pasaktësi të vogël; jep shembuj të kufizuar për ndikimet e këtyre lëvizjeve në reliev apo dukuri natyrore; përdor terminologji të pranueshme, por jo gjithmonë në mënyrë të qëndrueshme.	Nxënësi përmend disa pllaka tektonike, por mund të ngatërrojë vendndodhjen ose llojin e lëvizjes; jep përshkrime të përgjithshme për lëvizjen e pllakave, pa thellim konceptual; ka vështirësi në lidhjen e lëvizjeve me formimin e relievit ose dukuri si tërmetet; përdor terminologji të përgjithshme ose të pasaktë.	Nxënësi nuk identifikon saktë pllakat tektonike ose nuk kupton shpërndarjen e tyre; ka konceptime të gabuara për lëvizjen e pllakave ose nuk e shpjegon fare; nuk lidh lëvizjen me pasoja gjeologjike ose jep shembuj të pasaktë; nuk përdor ose përdor gabimisht terminologjinë bazë.

Në udhëzuesin kurrikular për lëndën e gjeografisë do të përshkruhen nivelet e arritjes për vlerësimin e rezultateve të të nxënit sipas tematikave të lëndës.

8 BURIMET DHE MATERIALET DIDAKTIKE

Përdorimi i mjeteve mësimore në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies në lëndën e gjeografisë është thelbësor për konkretizimin e ideve, kuptimin e dukurive natyrore e shoqërore dhe zhvillimin e kompetencave gjeografike. Këto mjete ndihmojnë në ilustrimin vizual të temave, në nxitjen e mendimit kritik dhe krijues, si dhe në zbatimin më të efektshëm të metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ato e bëjnë mësimin më dinamik, më të kuptueshëm dhe më tërheqës për nxënësit, duke rritur motivimin dhe angazhimin e tyre aktiv në klasë.

Zbatimi i suksesshëm i metodave dhe teknikave të mësimdhënies është i lidhur ngushtë me përdorimin e mjeteve didaktike të larmishme.

Mjetet mësimore mund të përfshijnë:

- Harta (fizike, ekonomike, administrative, topografike etj.), globi, atlas, albume, tablo, fotografi, skica, makete, diagramë, vjetarë statistikorë, manuale të të dhënave të elementeve klimatike, hidrografike, floristike, zoologjike, demografike etj.
- Mjete audio vizuale, si kompjuter, tablet, aparat projeksioni, aparat fotografik etj.
- Objektet natyrore janë mjete shumë efikase për të konkretizuar njohuritë e lëndës së gjeografisë. Në këtë grup futen koleksionet e ndryshme që krijohen me materiale të mbledhur nga natyra, si: gurë, minerale, drurë etj.
- Burime digjitale dhe interaktive: video demonstrative, filma dokumentarë që nxisin përfshirjen aktive të nxënësve, harta digjitale, kuize dhe lojra edukative, platforma digjitale si Google Maps, Google Earth etj. Këto mjete po zënë gjithnjë e më shumë vendin që u takon për konkretizimin e një sërë dukurive gjeografike.

Roli i mësuesit në këtë proces është kyç. Përveç organizimit të mësimit, ai ka detyrën të krijojë një mjedis stimulues dhe mbështetës, ku nxënësit kanë akses të barabartë në burimet mësimore. Këto burime nuk kufizohen vetëm brenda klasës, por përfshijnë edhe mjedise jashtëshkollore që pasurojnë përvojën e nxënësit, si muzeu, objekte të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, parqe kombëtare, zona të mbrojtura dhe monumente

natyrore. Në mënyrë të veçantë, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK) kanë rritur mundësitë e nxënësve për të kërkuar informacione, për të eksploruar harta interaktive, për të përgatitur prezantime, si dhe për të zhvilluar projekte kërkimore të bazuara në fakte dhe të dhëna gjeografike të përditësuara.

Në udhëzuesin kurrikular për lëndën e gjeografisë do të përshkruhet më në detaje përdorimi i burimeve dhe materialeve didaktike përfshirë teknologjinë.


9 REKOMANDIME TË TJERA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Zbatimi me sukses i programit të gjeografisë kërkon një qasje të integruar, gjithëpërfshirëse dhe të personalizuar, duke pasur në qendër nxënësin dhe zhvillimin e tij të plotë.

➤ *Lidhja e gjeografisë me lëndët dhe fushat e tjera*

Gjeografia është një urë lidhëse ndërmjet shkencave natyrore dhe shoqërore. Ajo ndihmon nxënësit të kuptojnë botën ku jetojnë, duke analizuar marrëdhëniet midis mjedisit natyror dhe veprimtarisë njerëzore. Kjo e bën gjeografinë një pikë kyçe ndërlidhëse me lëndë dhe fusha të tjera të kurrikulës.


Çfarë duhet të ketë parasysh mësuesi për integrimin ndërlëndor:



➤ *Zbatimet e lëndës në jetën reale dhe lidhja me tregun e punës dhe orientimin për karrierën*

Njohuritë dhe kompetencat e zhvilluara përmes gjeografisë janë thelbësore për jetën e përditshme dhe të përdorshme në një gamë të gjerë profesionesh. Ato ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë botën që i rrethon dhe të marrin vendime të informuara. Kjo qasje i ndihmon nxënësit të shohin vlerën e gjeografisë jo vetëm si një lëndë shkollore, por si një **mjet për jetë, karrierë dhe qytetari aktive**.

Orientimi në hapësirë, përdorimi i hartave dhe të dhënave gjeografike janë aftësi të dobishme në udhëtime, planifikim urban, hartim politikash mjedisore dhe menaxhim të emergjencave. Një sërë profesionesh janë të lidhura me përmbajtjen e gjeografisë si gjeograf, meteorolog, klimatolog, specialist i GIS, ekspert i menaxhimit të risqeve natyrore, mësues etj.



➤ *Ndërlidhja e gjeografisë me qasjen STEM*

STEM është një qasje ndërdisiplinore që përfshin Shkencën, Teknologjinë, Inxhinierinë dhe Matematikën. Gjeografia, si një shkencë natyrore dhe shoqërore, ka lidhje të ngushta me të gjitha komponentët e STEM.

Me shkencat e natyrës: Gjeografia përdor metoda shkencore për të kuptuar dukuritë natyrore (ndryshimet klimatike, tërmetet etj.) dhe për të hulumtuar mbi ndikimin e aktivitetit njerëzor në mjedis.

Me teknologjinë: Përdorimi i GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik), fotografisë ajrore dhe imazheve satelitore në analizën e hapësirës, përdorimi i aplikacioneve dhe platformave digjitale për të paraqitur dhe analizuar të dhëna gjeografike.

Me inxhinierinë: Planifikimi urban, ndërtimi i infrastrukturës në përputhje me karakteristikat gjeografike, vlerësimi i riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe përcaktimi i zgjidhjeve të qëndrueshme.

Me matematikën: Analiza statistikore e të dhënave gjeografike (të dhënat për popullsinë, sasinë e reshjeve, temperaturën e ajrit etj.), matja e distancave, përllogaritja e sipërfaqeve, ndërtimi i grafikëve dhe hartave.



➤ *Rekomandime për autorët e teksteve shkollore*

- Të përshtatin në mënyrë cilësore tekstet shkollore duke reflektuar të gjitha përditësimet më të fundit.
- Të përfshijnë në tekstet shkollore veprimtari që nxisin zhvillimin e aftësive të mendimit kritik e krijues, zgjidhjes së problemeve, përdorimit të teknologjisë, kërkimit gjeografik dhe bashkëpunimit.
- Të krijojnë hapësirë në tekstet shkollore për shembuj dhe veprimtari që nxisin orientimin për karrierë, përmes profesioneve ku gjeografia luan rol.
- Të sigurojnë që tekstet të kenë qasje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për moshën.

10 NDRYSHIMET PËRMBAJTËSORE

Programi mësimor i lëndës së gjeografisë për klasën e dhjetë është përditësuar dhe përfshin ndryshimet e mëposhtme:

- Përditësimi i kompetencave kyçe dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e dhjetë.
- Përditësimi i kompetencave të lëndës së gjeografisë dhe i rezultateve të të nxënit të përshtatura për klasën e dhjetë.
- Përditësimi i temave ndërkurrikulare.
- Përditësimi i metodologjisë me fokus të shtuar në zhvillimin e mendimit kritik, krijues, zgjidhjen problemore, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë, ndërlidhjen me qasjen STEM etj.
- Përditësimi i vlerësimit të nxënit bazuar në nivelet e arritjes sipas rezultateve të të nxënit.
- Vendosja e fokusit në situatat praktike të të nxënit duke e fokusuar rreth 40% të procesit mësimor në veprimtari konkrete praktike, duke krijuar përvoja që i ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë lidhje mes teorisë dhe praktikës. Mësuesi është fleksibël që në varësi të kontekstit të ndryshojë këto përqindje.
- Përditësimi i përmbajtjes me përfshirjen e rezultateve të të nxënit të cilat vendosin më në fokus temat ndërkurrikulare, si çështjet që lidhen me ndryshimet klimatike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe aftësitë e të menduarit kritik e krijues, zgjidhjes së problemeve, përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Në vazhdim janë prezantuar këto rezultate të nxëni sipas nëntematikave përkatëse.

a) Hartografia

Nxënësi:

- *Diskuton për rolin dhe përdorimet e teknologjisë në zhvillimet e sotme hartografike, si p.sh përdorimin e GIS (Sistemi i Informacionit Gjeografik), GPS (Sistemi i Pozicionimit Global), imazheve satelitore, fotografive ajrore, platformave digjitale Google Maps, Google Earth etj.*

b) Atmosfera:

Nxënësi:

- *Përcakton faktorët kryesorë që ndikojnë në ndryshimet klimatike.*
- *Krahason pasojat e ndryshimeve klimatike në Shqipëri me vende të tjera të Mesdheut dhe botës, duke kuptuar ndikimet e ndryshme lokale dhe globale.*
- *Përdor të dhëna klimatike (nga burime si p.sh., Instituti i Gjeoshkencave – IGJEO, platforma Copernicus etj.) për të analizuar ecurinë e temperaturës, të reshjeve dhe të dukurive ekstreme të motit (p.sh., thatësira të tejzgjatura, përmbytje për shkak të reshjeve të dendura, stuhi të fuqishme etj.) dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike në to.*

c) Hidrografia

Nxënësi:

- *Diskuton mbi shkrirjen e akullnajave, pasojat në gjeosistem dhe në veprimtarinë njerëzore.*

d) Dinamika e Tokës

Nxënësi:

- *Hulumton mbi ndikimin e ndryshimeve klimatike në intensifikimin e proceseve natyrore si rrëshqitjet, erozioni, shkretëtirëzimi etj.*
- Lidhja e gjeografisë me zbatimet e lëndës në jetën reale dhe lidhja me tregun e punës dhe orientimin për karrierën. Kjo qasje i ndihmon nxënësit të shohin vlerën e gjeografisë jo vetëm si një lëndë shkollore, por si një mjet për jetë, karrierë dhe qytetari aktive. Orientimi në hapësirë, përdorimi i hartave dhe të dhënave gjeografike janë aftësi të dobishme në udhëtime, planifikim urban, hartim politikash mjedisore dhe menaxhim të emergjencave. Një sërë profesioneesh janë të lidhura me përmbajtjen e gjeografisë, si gjeograf, meteorolog, klimatolog, specialist i GIS, ekspert i menaxhimit të risqeve natyrore, mësues etj.